



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Etika dhe
Lidershipi”**

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc.Dr. Elda Zotaj

PhD. Gert Guri

Janar /2025

**Tabela Përmbledhëse e të dhënave për Programin e studimit Master i Shkencave në
“Etika dhe Lidershipi” ofruar nga, Universiteti “Fan.S.Noli”,Korçë.**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Sociale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Etika dhe Lidershipi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr.545, datë 15.09.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr.193,dt 16.07.2024
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli shtatë (7)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2022-2023: 14 PAE / 2 PAK V.a 2023-2024: 14 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2022-2023: 20 studentë V.a 2023-2024: 12 studentë
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Programi i studimit master i shkencave në “Etika dhe Lidërshti” ofrohet nga Universiteti “Fan S. Noli” dhe zhvillohet nën kupolën e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane si dhe Departamentit të Shkencave Sociale. Programi është riorganizuar me Urdhër të MAS Nr.545, datë 15.09.2022, nga “Master i Shkencave në Filozofi Sociale” siç ishte licensuar fillimisht në “Master i Shkencave në Etika dhe Lidërshti”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane përbëhet nga pesë departamente: 1) Departamenti i Bilogji-Kimisë; 2) Departamenti i Infermierisë; 3) Departamenti i Matematikës dhe Fizikës; 4) Departamenti i Informatikës; 5) Departamenti i Shkencave Sociale ku bën pjesë edhe programi i marrë në shqyrtim për akreditim. Këto departamente ofrojnë programe të ciklit të parë dhe të dytë dhe programe të ciklit të tretë të studimeve.

Programi i studimit master i shkencave në “Etika dhe Lidërshti” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, 120 ECTS dhe kohëzgjatje të rregullt 2 vite akademike.

Programi i studimit master i shkencave në “Etika dhe Lidërshti” i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe sipas drejtuesve të IAL është konceptuar në përputhje me standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Nga takimi me studentë të këtij programi studimi doli në pah që ata mbështën shumë nga stafi akademik duke përfshirë studentët në punët e tyre kërkimore, organizmin e konferencave, organizimin e eventeve dhe përditësimin në të reja më të fundit në fushat kryesore të zhvillimit shoqëror siç janë etika, menaxhimi, edukimi, mjedisi, të drejtat e njeriut, çështjet sociale, krijimi i bindjeve dhe besimit për të përmbushur një qytetari aktive.



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM:

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (www.ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof.asoc.dr. Elda Zotaj ekspert vendas dhe drejtues i GVJ dhe Dr. Gert Guri ekspert i huaj. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga koordinatoresha teknike e ASCAL Alma Arapi.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat **29 dhe 30 Prill 2024** sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë Master i Shkencave në “Etika dhe Liderhipi”, si edhe ofron sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të profesionistëve.



Universiteti "Fan.S.Noli", Korçë është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 08.01.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 07 Prot, datë 08.01.2025. Universiteti "Fan.S.Noli" Korçë, njofton në ASCAL më datë 15.01.2025, me anë të shkresës me Nr.61/1 Prot, datë 15.01.2025 " Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtar si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Etika dhe Liderhipi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit, master i shkencave në “Etika dhe Liderhipi”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane (FSHNSHH) njësi kryesore pranë universitetit “Fan S. Noli” (në vijim UNIKO), është ristrukturuar dhe riemërtuar që të jetë në harmoni me interesat kombëtare të vendit, duke kontribuar në formësimin e specialistëve të aftë të zhvillojnë dhe aplikojnë më tej njohuritë dhe kompetencat në drejtimin e institucioneve në nivel lokal e qëndror përmes zhvillimit të aftësive menaxhuese dhe respektimit të standardeve të etikës dhe liderhipit. Universitetit “Fan S. Noli” ka të shprehur qartë në vizionin dhe misionin e përcaktuar në statutin e tij që kontribuon në zhvillimin arsimor, ekonomik dhe të qëndrueshëm të komuniteteve lokale dhe më gjërë, nëpërmjet ofrimit të programeve të studimit të njohura dhe të vlerësuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive profesionale dhe kërkimore, për tu përballur denjësisht e kërkesat e tregut të punës. Programet e studimit që ofron ky universitet kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë dhe larmishmërisë së ideve për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike, shtetit të së drejtës, mirëqënies së shoqërisë përmes ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e kulturore kombëtare. Brenda këtij kuadri statutor dhe bazuar në ligjin e arsimit të lartë nr. 80/2015, universitetit “Fan S. Noli” funksionon dhe i përgjigjet ndryshimeve dhe nevojave të tregut dhe të shoqërisë. <i>Annex Nr 1.1 Statuti i UK, fq.2</i> <i>Annex Nr. 1.3 Plani strategjik i zhvillimit te UNIKO</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe	Programi master i shkencave “Etika dhe Liderhipi” është në përputhje me misionin dhe qëllimet e universitetit “Fan S. Noli” dhe



ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë që është Departamenti i Shkencave Sociale përgjegjës për programin e studimit. Në Planin Strategjik të Zhvillimit 2022-2027 të Universitetit “Fan S. Noli” janë përcaktuar objektivat për arritjen e misionit të institucionit ku ndër të tjera përcaktohet se “Të përgatisë profesionistë e qytetarë aktiv për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat evropiane”. <i>Annex Nr. 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO. fq.8</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	Referuar evidencave mbi dokumentet strategjike dhe bisedave me drejtuesit e universitetit “Fan S. Noli”, konfirmohet se programi i studimit është riorganizuar për t’ju përshtatur më mirë nevojave të tregut për profesionet e kërkuara si dhe harmonizimit më strategjinë dhe planin strategjik të zhvillimit, statutit dhe rregullores së institucionit. Institucioni ka një vizion të qartë për zhvillimin afatgjatë të studimeve në fushën e Shkencave Sociale të lidhura me kuadrin e strategjisë të institucionit. Programi i studimit përshtatet me drejtimin akademik të Departamentit të Shkencave Sociale. Emërtimi, struktura dhe organizimi i programit të studimit bazohet dhe është ndërtuar mbi fushat e drejtimit akademik dhe të kërkim zhvillimit të UK. Në hartimin e programit të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave “Etika dhe Liderhipi”, synohet të formohen studentët me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale nëpërmjet mësimdhënies, aftësimit për përdorimin e arritjeve më të mira të teorisë, praktikës dhe shkencës në lëmin e shkencave sociale me orientim etikën dhe liderhipin. <i>Annex Nr. 1.1 Statuti i UK;</i> <i>Annex Nr. 1.2 Rregullorja e UNIKO;</i> <i>Annex Nr. 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO;</i> <i>Annex Nr. 2.3 Rregullorja e njësisë bazë</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë	GVJ konfirmon se nga shqyrtimi i dokumentacionit të Universitetit “Fan S. Noli” dhe bisedat me stafin drejtues të institucionit, riemërtimi i programit të studimit përputhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim të qeverisë shqiptare dhe prirjet globale të zhvillimit ku investimi në kapacitete humane me standardet demokratike i shërbejnë konsolidimit të institucioneve dhe janë në funksion të zhvillimit të qendrueshëm politik dhe ekonomik të vendit. Programi i studimit Master i Shkencave në “Etika dhe Liderhipi” është hartuar e zhvillohet në përputhje me dokumentat strategjike të institucionit në përputhje me interesin kombëtar, si dhe prirjet lokale, rajonale dhe globale të zhvillimit



ndërkombëtar.	politik dhe ekonomik të vendit dhe më gjerë. Kurrikula e këtij programi studimi është hartuar duke u bazuar në dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare dhe i shërben formimit të profesionistëve në të gjitha nivelet <i>Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit_organized</i>. Programi synon të formojë specialistë, njohës të administrimit dhe menaxhimit të institucioneve në nivele të ndryshme të cilët do ti shërbejnë rritjes së performancës së institucioneve të shtetit dhe organizmave ndërkombëtare që zhvillojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë, si dhe zhvillimit ekonomik dhe social në tërësi. <i>Annex Nr 2.4 Plani strategjik për zhvillimin e programit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, konfirmon se Universitetit “Fan S. Noli” ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Programi i studimit master i shkencave “Etika dhe Liderhipi” synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare dhe është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit. Programi i studimit është riorganizuar për t’ju përshtatur më mirë nevojave të tregut të punës, akteve rregullatore dhe planit të zhvillimit të universitetit “Fan S. Noli”. Programi është në harmoni me interesat kombëtare të vendit, duke kontribuar në formësimin e specialistëve të fushës të aftë të zhvillojnë më tej standardet e menaxhimit dhe liderhipit në institucionet e vendit dhe më gjerë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në	Universiteti “Fan.S.Noli” Korçë (UK) është një institucion publik i arsimit të lartë, hapur me VKM-në Nr.5, datë 07.01.1992 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (më i fundit) Nr. 02, datë 27.01.2023. Universitetit “Fan S. Noli” është një institucion arsimor me kontribute, traditë dhe vlera të larta në fushën e arsimit të lartë në veçanti për pjesën e juglindjes së vendit. Nga viti i themelimit e deri më sot, universiteti ka realizuar

atë fushë.

procese reformuese dhe përmirësim të vazhdueshëm të strukturave, njësive dhe programeve. Ky program ka ardhur nga riorganizimi i programit Master i Shkencave në "Filozofi Sociale" në Master i Shkencave në "Etika dhe Liderhipi", miratuar me UMASR Nr. 545, datë 15.09.2022. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane në vitin akademik 2023-2024

Personeli i angazhuar në FSHNSHH	Viti akademik 2023-2024	
	PAE	PAK
Prof Dr	2	6
Prof.Assoc	2	5
Dr/Doc	26	6
Msc	19	44
Në total	49	61

Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në vitin e fundit akademik 2023-2024 në **Departamentin e Shkencave Sociale**, rezultojnë me të dhënat si më poshtë:

Personeli i angazhuar në DSHS	Viti akademik 2023-2024	
	PAE	PAK
Prof Dr	1	-
Prof.Assoc	3	2
Dr/Doc	9	-
Msc	1	-
Në total	14	2

Nga shqyrtimi i jetëshkrimeve të stafit, departamenti ka në përbërje staf akademik me tituj dhe grada, eksperiencë, kualifikime dhe punë shkencore që i përgjigjen nevojave të këtij program studimi.

Annex Nr 1.1 Statuti i UK

Annex Nr 1.21 Organika dhe struktura e UNIKO, fq.14-15

	Annex Nr 2.9 Jetëshkrimet e stafit Annex +Tabelat permbledhese per Aneks_RVB MSC EL
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi master i shkencave “Etika dhe Lidershipi” organizohet në nivelin 7 sipas kornizës evropiane dhe kombëtare të kualifikimeve. Fusha akademike e programit të studimit dhe Departamenti i Shkencave Sociale i takon fushës së studimeve Sociale (kategoria nr.3), kurse fakulteti ku ai ndodhet i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane është një ndërthurje e dy fushave të tjera të studimit, asaj të Shkencave (kategoria nr.4) dhe Shkencave Humane (kategoria nr.2) dhe sipas klasifikimit ndërkombëtar ISCED 2011 (burimi: https://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-isced-2011-en.pdf). Në takimin me drejtues në institucionit u shpreh dhe shqetësimi që departamenti dhe programi i studimit duhet të qëndrojnë në një njësi kryesore që i përshtatet klasifikimit dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Ky klasifikim është sanksionuar edhe nga qeveria shqiptare me VKM nr.288, date 11.05.2022 dhe VKM nr.310, date 11.05.2022. Është e nevojshme që pas procesit të akreditimit të programit, vlen të konsiderohet kjo çështje nga institucioni. Annex Nr 1.1 Statuti i UK Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2023-2024 Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit _organized
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit master i shkencave “Etika dhe Lidershipi” përputhet me fushën akademike dhe punën kërkimore të personelit akademik të Departamentit të Shkencave Sociale. Njësia bazë është e konsoliduar në burimet njerëzore dhe ka kompetencat e nevojshme për të ofruar një program të tillë. Në vitin 2023-2024 departamenti kishte në përbërje staf akademik efektiv me tituj dhe grada si vijon: (1) prof.dr; (3) prof.asoc; (9) doktor shkencash; dhe (1) Msc (dr në proces). Staf akademik me kontratë ishin (2) me titullin prof.asoc.dr. Programi ka karakter ndërdisiplinor ku ndërthuren njohuri në fushën e komunikimit ndërkulturor, të filozofisë morale, të etikës profesionale dhe bioetiken, njohuri juridike, menaxhuese, financiare etj. Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2023-2024 Annex Nr 2.9 Jetëshkrimet e stafit Annex Nr 4.8 Tabela e të dhënave për kualifikimin dhe kërkimin shkencor

	Annex +Tabelat permbledhese per Aneks_RVB MSC EL			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në RVB, përsa i përket këtij kriteri thuhet se “Hapësirat e trajnimeve të vazhduara të profesionistëve të diplomuar në këtë program përbëjnë një nga prioritetet e zhvillimit strategjik të këtij program në mbështetje të UNIKO dhe marrëveshjeve të ndënshtkruara institucionale kombetare dhe ndërkombëtare. Pra institucioni e ka në planin strategjik sipërmarrjen për një hap të tillë, por ende nuk e ka realizuar. Annex Nr RVB, fq.15-16 Annex Nr 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO			
Konkluzione	GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, konfirmon se Departamenti i Shkencave Sociale si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, është e konsoliduar në burimet njerëzore dhe ka kompetencat për të ofruar një program të tillë Master Shkencor. Referuar mospërputhjes së fushës së programit të studimit në Shkenca Sociale (Kategoria nr.3) me njësinë kryesore, Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane (Kategorive nr. 4 dhe nr.2) sipas standardeve ndërkombëtare ISCED 2011, kërkohet reflektim nga institucioni që të përmbushë si standardet ndërkombëtare ISCED, edhe legjislacionin shqiptar si VKM nr.288, date 11.05.2022 dhe VKM nr.310, date 11.05.2022.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave dhe përgjegjësiwe në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit është e përcaktuar në Statutin dhe Rregulloren e UNIKO, FSHNSHH (njësia kryesore), DSHS (njësia bazë) dhe programit të studimit. UniKo ka krijuar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit duke ndarë detyrat mes njësive dhe personelit, marrë përgjegjësiw përkatëse dhe analizuar vazhdimisht punën e tyre. Programi zbatohet nga njësia bazë DSHS si përgjegjësiwa kryesore për implementimin e tij. Për mbarëvajtjen e programit, departamenti ka marrëdhënie me njësi të tjera të Fakultetit dhe të Universitetit, sikurse u konfirmua nga takimet me drejtuesit e FSHNSHH dhe DSHS gjatë vizitës në institucion. Bashkëpunimi lidhet me aspekte të realizimit të lëndëve të programit mësimor, burimeve njerëzore dhe sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, përmes Planit Strategjik të Zhvillimit, institucioni përfshin të gjithë anëtarët e komunitetit universitar, nga stafi mësimor dhe administrativ deri te studentët, të cilët janë të përkushtuar për të shpalosur mundësiw e tyre në auditorë, laboratorë, biblioteka dhe konferenca shkencore. <i>Annex Nr 1.1 Statuti i UK</i> <i>Annex Nr 1.2 Rregullorja e UNIKO</i> <i>Annex Nr 2.2 Rregullorja e njësisë kryesore</i> <i>Annex Nr 2.3 Rregullorja e njësisë bazë</i> <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2022-2023</i> <i>Annex Nr 1.3 Plan i strategjik i zhvillimit të UNIKO</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimet në institucion dhe kqyrja e websit-it të UNIKO evidentohet se institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. UniKo ka nënshkruar rreth 127 marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere, kërkimore brenda dhe jashtë vendit të tilla të cilat përfshijnë dhe realizimin e objektivave të procesit mësimor formues të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter shkencor. Rreth 19 marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar me institucione, organizata dhe biznese të ndryshme nga njësia kryesore dhe ajo bazë me qëllim realizimin e praktikave studentore në kuadër të realizimit të procesit mësimor (Annex Nr 3.5). Universiteti është pjesë e rrjeteve universitare ASCEC, AUF, UNIMED, CDS etj GVJ e konsdieron si praktikë të mirë shfrytëzimin e përvojës pozitive në bashkëpunimin me universitetet ndërkombëtare për të zhvilluar projekte të përbashkëta dhe për të rritur mundësiw për studentët për shkëmbime ndërkombëtare. Gjithashtu, Universiteti




	shfrytëzon marrëveshjet e mobilitetit Erasmus + me universitete të ndryshme që mundësojnë shkëmbime të stafit akademik, administrativ dhe të studentëve për të qenë pjese e mobiliteteve, trajnimeve, pjesëmarrjes në aktivitete dhe projekte kërkimi, praktika mësimore, punësimi dhe zhvillimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar etj. <i>Annex Nr 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO</i> <i>Annex Nr 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave</i> <i>Annex Nr 3.5 Tabela e institucioneve të bashkëpunimit të praktikave</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Institucioni garanton marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm lokalë dhe kombëtarë për realizimin e objektivave të procesit mësimor. Nga takimet në UNIKO me stafin akademik të DSHS dhe studentët, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konfirmohet se institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me institucione që ofrojnë mundësitë për kryerjen e praktikës profesionale nga studentët. Praktikën profesionale realizohen në bazë të marrëveshjeve që institucioni ka me organizma të ndryshëm. Njësia kryesore dhe ajo bazë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimit me institucionet publike (Prefekturën e qarkut Korçë; Bashkia Korçë; zyra e punës dhe çështjeve sociale etj), bizneset private apo organizatat profesionale, kompani për realizimin e praktikave profesionale. Gjatë bisedës me studentët rezultoi se ata kanë liri të zgjedhin dhe negociojnë mundësitë për kryerjen e praktikës profesionale në institucionet me të cilat janë në kontakt. Në shumicën e rasteve, praktika profesionale drejtohet nga iniciativa e studentëve. Secili student mbikqyret nga një supervisor tek institucioni pritës. Përshkrimi i detajuar i punës nga vetë studentët dhe vlerësimi i institucionit janë elementët kyç të vlerësimit të praktikës. Kjo evidentohet në marrëveshjet e nënshkruara dhe në dokumentat për vlerësimin e praktikës, përkatësisht formularët dhe raportet e internshipit, që dorëzohen nga studentët. <i>Annex Nr 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave</i> <i>Annex Nr 3.5 Tabela e institucioneve të bashkëpunimit të praktikave</i> <i>Annex Nr 3.6 Raporti i përfutimit nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia	Nga takimet në UNIKO me drejtuesit e FSHNSHH dhe stafin akademik të DSHS, GVJ konstatoi se ata i konsideronin

përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	marrëveshjet e bashkëpunimit të rëndësishme për realizimin praktikën mësimore, tërheqjen e opinionëve për nevojat e tregut të punës dhe aktivitete të tjera. Raportet analitike të përfitimeve nga këto marrëveshje hartohen periodikisht nga Departamenti i Shkencave Sociale. Këto raporte ndihmojnë në vlerësimin e efektivitetit të praktikave dhe në përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit. Annex Nr 3.6 Raporti i përfitimit nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit Annex Nr 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë të njësive bazë			
Konkluzione	UniKo ka krijuar marrëdhënie të frytshme brenda institucionit për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse. Ndërkaq, në aspektin e bashkëpunimit me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, institucione publike, biznese etj, UniKo ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh (127 të tilla), duke krijuar mundësi të shkëmbimeve të stafit dhe studentëve, si dhe aplikime në projekte ndërkombëtare. Për realizimin e praktikave profesionale, institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucione dhe biznese përkatëse për të siguruar përvojë praktike për studentët. Njësia bazë harton raporte analitike periodike për të vlerësuar përfitimet nga këto marrëveshje dhe për të përmirësuar programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1


Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Përmbajtja dhe struktura e programit master i shkencave në “Etika dhe Liderशिpi”, syllabuset e lëndëve dhe organizimi në 4 semestra, përcaktojnë qartë qëllimet, objektivat, dijet dhe kompetencat që studentët përfitojnë në përfundim të programit të studimit. Programi ka në total 120 kredite (ECTS), është me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, me kohë zgjatje 2 vite akademike, i shtirë në 4 semestra. Programi është i organizuar në lëndë/module, i vlerësuar në kredite. Programi përmban lëndët sipas kategorizimeve të përcaktuara duke respektuar plotësisht legjislacionin kombëtar Ligjin nr. 80/2015, datë 25.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). <i>Urdhër Nr.545, datë 2022-09-15</i> <i>Urdhër Nr.193, datë 2024-07-16</i> <i>Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit_organized</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve	Programi i studimit, master i shkencave në “Etika dhe Liderशिpi” synon t’i pajisë studentët me njohuri, aftësi dhe kompetenca të nivelit të lartë dhe përgjegjësi qytetare. Programi i studimit synon që nëpërmjet trupës së lëndëve si dhe profilizimet e ofruara, t’u japë studentëve njohuri sa më koherente gjithëpërfshirëse dhe terminologjinë e duhur që ju duhet në formimin e tyre profesional. Disa nga objektivat formuese të programit janë: Rritja e aftësive profesionale të specialistëve dhe drejtuesve të organizatave, institucioneve shtetërore dhe private. Zhvillimi i aftësive menaxheriale të drejtuesve duke rritur në këtë mënyrë dhe rolin e tyre si drejtues. Formimin e specialistëve, nëpunësve dhe drejtuesve me karakteristikat e profesionistëve me parime etike dhe vlera



komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	morale. Rritja e shkallës së njohurive të specialistëve në fushën e etikës dhe moralit, politike, ligjore, ekonomike dhe teknologjike, pasi këto ndikojnë në procesin e vendimmarrjes, cilësisë së tyre dhe aplikimit efektiv. Etj. Në syllabuset e lëndëve shprehen qartë dhe në mënyrë eksplicite rezultatet e të nxënit dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të çdo lënde. Aftësitë shprehimore e teknike i lejojnë studentët për t'u përballur me specializime profesionale në punë të kualifikuara ku nevojiten njohuritë që lidhen me këtë program studimi. <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2022-2023</i> <i>Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit_organized</i> <i>Annex Nr 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit master i shkencave në “Etika dhe Liderशिpi”, ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Konkretisht, praktika profesionale ka 5 ECTS dhe realizohet në 5 javë ku studenti duhet të qëndrojë jo më pak se 5 orë pune çdo ditë për periudhën e përcaktuar, ndërsa punimi i diplomës ka 18 ECTS. <i>Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit_organized</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të	Nuk aplikohet.

krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Në rregulloren e programit të studimit (fq.10-14) janë të përcaktuara kriteret e pranimi dhe kostoja financiare e studimit. Pranimi në programin e studimit master i shkencave në “Etika dhe Liderhipi” realizohet në bazë të përzgjedhjes të bërë nga IAL-ja sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe sipas kriterëve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht. Në rregulloren e programit (fq.12) përcaktohen 5 kuota të dedikuara për studentë të kategorive të veçanta si: me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, romë dhe ballkano – egjiptian, si dhe nga trojet shqiptare. Tarifa e studimit është e përcaktuar në masën 150.000 ose 1.250 lekë/kredit. Gjithashtu në respektim të VKM nr.780 datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”, për studentët që i përkasin kategorive të përcaktuara në këtë dokument institucioni aplikon ulje të tarifës sipas përcaktimeve përkatëse. <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit2022-2023</i> <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit2023-2024</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bazuar në RVB dhe hulumtimin e realizuar nga ekspertët konfirmohet se programi i studimit master i shkencave në “Etika dhe Liderhipi” ka përmbajtje të ngjashme në masën 70% me programin e ofruar nga Universiteti i Tiranës, FSHS, Departamenti i Filozofisë, me titull “Etika në institucione dhe liderhipi”. <i>Annex Nr RVB</i> https://fshs-ut.edu.al/?page_id=266
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra	Në zbatim të VKM nr.288, datë 11.05.2022 dhe VKM nr.310, datë 11.05.2022, si edhe Udhëzimi Nr.31, datë 15.11.2022 "Për Procedurat Për Kodifikimin e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", institucioni ka realizuar procesin e kodifikimit të programeve dhe



publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	ka njoftuar Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me anë të shkrësës me nr. Prot 85/3 datë 21.02.2023. Në praktikën e kodifikimit, programi i studimit master i shkencave në "Etika dhe Liderशिpi" ka të përcaktuar kodin 72MS0223S. <i>Annex Nr 2.17 Praktika e kodifikimit të programeve të studimit</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet.			
Konkluzione	Programet e studimit në UniKo janë të organizuara në module dhe vlerësohen me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), në përputhje me legjislacionin vendas. Konkretisht, programi master i shkencave në "Etika dhe Liderशिpi" është i strukturuar në 120 kredite dhe është në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi synon të ofrojë njohuri dhe të zhvillojë aftësi profesionale dhe kompetenca të nivelit të lartë dhe përgjegjësi qytetare në fushën e etikës dhe liderशिpit. Kjo arrihet përmes një stafi akademik të kualifikuar dhe praktikave profesionale në ambiente të ndryshme, për të përgatitur profesionistë. Programi ka objektiva të qartë për formimin profesional të studentëve, duke përshtatur dijet dhe aftësitë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ngarkesa në kredite është përcaktuar qartë për të gjitha lëndët/modulet, përfshirë praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, duke siguruar një përvojë të plotë arsimore për studentët. Organizimi dhe pranimi i studentëve janë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Programi është kodifikuar në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe evropiane, në zbatim të VKM nr.288, date 11.05.2022 dhe VKM nr.310, date 11.05.2022, si edhe Udhëzimi Nr.31, datë 15.11.2022.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																	
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit bazë të UMNICO dhe vizitës në institucion, GVJ gjykon se FSHNSHH si njësi kryesore dhe DSHS si njësi bazë ku ofrohet programi i studimit, përmbushin detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik dhe funksionojnë në bazë të legjislacionit mbi arsimin e lartë. FSHNSHH dhe DSHS përmbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, për vlerësimin dhe akreditimin e programit në tërësi. Stafi akademik i FSHNSHH përbëhet nga 49 anëtarë PAE dhe 61 PAK. DSHS ka numrin e nevojshëm të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit më konkretisht në vitin e parë të studimeve 2022-2023 janë angazhuar në total 9 personel akademik nga të cilët: 7 personel akademik PAE dhe 2 personel akademik PAK. Përgjatë vitit akademik 2023-2024 për vitin e dytë të studimeve në këtë program studimi u angazhuan 7 personel akademik të gjithë PAE. Numri i personelit akademik të DSHS për vitin akademik 2023-2024 rezulton në 14 nga ku (1) – prof. dr; (3) – prof. asoc; (9) – doktor shkencash; (1) Msc (në proces doktorature). Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore GVJ konstatoi se është i depozituar dokumentacioni për stafin e angazhuar dhe të dhënat e personelit përditësohen. GVJ pati mundësi për t’i konfirmuar gjatë vizitës në institucion. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane në vitin akademik 2023-2024 <table><tr><th rowspan="2">Personeli i angazhuar në FSHNSHH</th><th colspan="2">Viti akademik 2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof Dr</td><td>2</td><td>6</td></tr><tr><td>Prof.Assoc</td><td>2</td><td>5</td></tr><tr><td>Dr/Doc</td><td>26</td><td>6</td></tr><tr><td>Msc</td><td>19</td><td>44</td></tr></table>	Personeli i angazhuar në FSHNSHH	Viti akademik 2023-2024		PAE	PAK	Prof Dr	2	6	Prof.Assoc	2	5	Dr/Doc	26	6	Msc	19	44
Personeli i angazhuar në FSHNSHH	Viti akademik 2023-2024																	
	PAE	PAK																
Prof Dr	2	6																
Prof.Assoc	2	5																
Dr/Doc	26	6																
Msc	19	44																



	<table><tr><td>Në total</td><td>49</td><td>61</td></tr></table>	Në total	49	61																	
Në total	49	61																			
	Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në vitin e fundit akademik 2023-2024 në Departamentin e Shkencave Sociale, rezulton me të dhënat si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Personeli i angazhuar në DSHS</th><th colspan="2">Viti akademik 2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof Dr</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.Assoc</td><td>3</td><td>2</td></tr><tr><td>Dr/Doc</td><td>9</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Në total</td><td>14</td><td>2</td></tr></table>	Personeli i angazhuar në DSHS	Viti akademik 2023-2024		PAE	PAK	Prof Dr	1	-	Prof.Assoc	3	2	Dr/Doc	9	-	Msc	1	-	Në total	14	2
Personeli i angazhuar në DSHS	Viti akademik 2023-2024																				
	PAE	PAK																			
Prof Dr	1	-																			
Prof.Assoc	3	2																			
Dr/Doc	9	-																			
Msc	1	-																			
Në total	14	2																			
	<i>Annex Nr 1.21 Organika dhe struktura e UNIKO</i> <i>Annex Nr 4.1 Tabela e personelit akademik në programin e studimit</i>																				
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	FSHNSHH dhe DSHS kanë stafin e nevojshëm ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ligji në fuqi. GJVJ konstaton se është 1 (një) personel ndihmës akademik në DSHS. Nga takimi me personelin akademik dhe ndihmës akademik të Departamentit, si dhe me komunikimet nga studentët, GJVJ konfirmon se ata kanë një bashkëpunim të ngushtë me institucionet ku zhvillohen praktikat mësimore sipas planit mësimor, në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve Master. Praktika profesionale zhvillohet pranë institucioneve me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. <i>Annex Nr 1.1 Statuti i UK</i> <i>Annex Nr 1.21 Organika dhe struktura e UNIKO</i> <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2023-2024</i>																				
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e	Sipas përcaktimit në rregulloren e FSHNSHH (fq.11-12) kreu II neni 14 pika 4 thuhet se: “koordinatori është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tyre”. Në aktet rregullative të njësisë kryesore dhe bazë janë të mirëpërcaktuara detyrat dhe funksionet e koordinatorit për																				




koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	shumë aspekte të veprimtarisë së tij brenda departamentit. <i>Annex Nr 2.2 Rregullorja e njësisë kryesore</i> <i>Annex Nr 2.3 Rregullorja e njësisë bazë</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit master i shkencave në "Etika dhe Liderशिpi" respekton rregulloret e brendshme të Departamentit të Shkencave Sociale, Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane dhe Universitetit "Fan S. Noli" Korçë. Këto rregullore janë në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e UNIKO.</i> <i>Departamenti i Shkencave Sociale ka një staf akademik prej 14 pedagogësh të kualifikuar dhe personel ndihmës akademik të cilët realizojnë proceset mësimore, dhe praktikat profesionale. Në aktet rregullative, institucioni ka të përcaktuar dhe rolin e koordinatorit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në DVV si dhe takimet me drejtuesit e programit të studimit, GVJ mori të gjithë informacionet e nevojshme, për të gjithë elementët e programit: organizimin, përmbajtjen dhe strukturën e tij. FSHNSHH si njësia kryesore dhe DSHS si njësia bazë ku ofrohet programi i studimit, kanë të plotë infrastrukturën për realizimin e programit të studimit. Të gjitha të dhënat jepen në: - Rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli Korçë"; - Rregullore e njësisë kryesore; - Rregullore e njësisë bazë; - Rregulloren e Programit të Studimit;

	- Plani mësimor; - Programi për çdo lëndë Annex Nr 1.2 Rregullorja e UNIKO Annex Nr 2.2 Rregullorja e njësisë kryesore Annex Nr 2.3 Rregullorja e njësisë bazë
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen në lëndë, praktikë dhe punimi i diplomës të shprehura në kredite ECTS dhe të grupuara brenda dhe jashtë auditorit. Ky program i studimit ka një ngarkesë prej 120 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje studimi prej 2 vitesh (60 ECTS për vit) ose 4 semestra (30 ECTS për semestër). Plani mësimor jep edhe ngarkesën mësimore dhe orët në auditor ku çdo ECTS përbën 25 orë studim dhe në një vit akademik me 60 ECTS mesatarisht 1500 orë studimi. Plani mësimor është i qartë, në semestrin e parë zhvillohen lëndë plotësuese dhe karakterizuese, të gjitha të detyrueshme. Në semestrin e dytë zhvillohen lëndë bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore integruese. Në semestrin e tretë zhvillohen lëndë karakterizuese dhe ndërdisiplinore integruese dhe me zgjedhje. Në semestrin e katërt dhe e fundit zhvillohet një lëndë, praktika mësimore dhe punimi i diplomës. Praktika si lëndë Plotësuese (D) përbën 5 ECTS dhe Detyrime Përmbyllëse (E), Tema e Diplomës ose Mikroteza përbën 18 ECTS. Struktura e programit është në respektim të Ligjit Nr.80, datë 22.07.2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të”, VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” I ndryshuar. Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit_organized Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2023-2024
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit ka të përcaktuar qartë kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve në programin e studimit Master Shkencor të cilin mund ta ndjekin studentët nga universitetet shqiptare publike e private dhe nga trojet shqipfolëse. Procedurat e pranimit përcaktohen në aktet rregullatore të institucionit, përfshirë rregulloren e programit të studimit dhe shpallen në të gjitha mjetet e informimit të institucionit. Procedurat e pranimit të studentëve të rinj realizohen nga një komision i veçantë pedagogësh duke marrë parasysh vit pas viti kriteret bazë të vendosura nga Ministria përgjegjëse për arsimin. Programi është i organizuar në mënyrë që të lejojë transferim të studimeve nga/në programe të tjera, duke bërë ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS, sikurse kishte studentë të kthyer




	nga universitetet jashtë vendit në takimin me GVJ në institucion. Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet rregullatore të UMSH. <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2023-2024</i> <i>Annex Nr 2.13 Të dhëna mbi kriteret e pranimi të prog të stud, tarifat dhe modalitet financ</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit master i shkencave në “Etika dhe Liderhipi” organizohet në lëndë, praktikë dhe punimi i diplomës të shprehura në kredite ECTS dhe të grupuara sipas komponentëve mësimorë formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Në programet e lëndëve (syllabuset) si pjesë integrale e planit mësimor gjenden të pasqyruara elementët e përcaktuara nga aktet ligjore e nënligjore (Vendimi Nr. 879, datë 18.12.2019), duke theksuar sidomos përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënës, konceptet themelore, objektivat e lëndës dhe mënyrën e vlerësimit. Vend të veçantë zë përmbajtja e temave dhe çështjet kryesore brenda tyre, shoqëruar me literaturën bazë dhe atë të rekomanduar. Format e mësimdhënies dhe të kontrollit të njohurive për lëndën jepen të detajuara, në funksion të orientimit dhe transparencës ndaj studentëve për vlerësimin e tyre. <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2023-2024</i> <i>Annex Nr 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Syllabuset janë të detajuara dhe u bëhen me dije studentëve çdo fillim semestri të vitit akademik dhe përditësohen nga stafi akademik sipas nevojave. Rishikimi dhe përditësimi i lëndëve të ofruara në këtë program studimit është kompetencë e DSHS, dhe çdo syllabus përditësohet dhe miratohet përpara fillimit të çdo viti akademik nga departamenti. Syllabusi paraqitet nga titullari i lëndës, i cili ka të paktën gradën “Doktor i Shkencave”. Analiza e syllabusit merr parasysh të gjithë elementët e tij thelbësorë duke u ndalur në përputhjen e plotë të tij me planin mësimor, bazën ligjore në fuqi, aktet rregullatore të miratuara në nivel institucionale si dhe kërkesat e tregut të punës. <i>Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ vëren se në vijim nevojitet që për ato programe lëndore (psh: Probleme të moralit; moduli SPSS; Teoritë e përfaqësimit dhe vendimmarrje; etj) që nuk kanë literaturë të 5 viteve të fundit tek literatura e detyruar është e nevojshme përditësimi i saj me botimet më të reja. Rifreskimi i literaturës, përshtatja e temave të trajtuara me zhvillimet bashkëkohore janë elemente të rëndësishme të rishikimit të syllabusit.</i> <i>Annex Nr 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i>

	Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2023-2024			
Konkluzione	GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, i është referuar Planit Mësimor dhe Syllabuseve të lëndëve të ofruara në këtë program Master. DSHS për organizimin e veprimtarisë mësimore, këkimore- shkencore dhe administrative, mbështetet në Ligjin Nr.80, datë 22.07.2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të”, VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Plani Mësimor i programit dhe syllabuset e lëndëve ofrojnë si në përmbajtje, edhe në formë të gjithë informacionin e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, duke respektuar si aspektet ligjore edhe rregulloret e brendshme të institucionit mbi kriteret e pranimit dhe transferimet e studentëve. Programi i studimit organizohet sipas strukturës së nevojshme për një program studimi të ciklit të dytë. Sugjerohet që syllabuset që nuk kanë literaturë bazë të viteve të fundit të shikohet mundësia për përditësimin e vazhdueshëm i literaturës me botimet më të reja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të	Programi i studimit master i shkencave në “Etika dhe Liderhipi” ofron njohuri dhe kompetenca teorike dhe metodologjike, si dhe aftësi të kërkimit shkencor në drejtim të thellimit të njohurive, specializimin dhe ngritjen e nivelit akademik në fushën e etikës dhe liderhipit si dhe mundëson zhvillimin e kompetencave në fushën institucionale të administrimit publik, menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësive të drejtimit. Programi ka në fokus shpërndarjen e lëndëve dhe praktikës mësimore duke i mundësuar studentëve të programit thellimin e aftësive të vendimmarrjes, komunikimit dhe drejtimit, duke u përqëndruar në ndikimin e etikës profesionale si dhe aftësive që ndihmojnë në zhvillimin e ekspertizës në profile të kërkuara nga tregu dhe të avancimit në karrierë. Në përfundim të programit të studimit, studenti mund të ushtrojë profesionin në një shumëllojshmëri specialitetesh si nëpunës apo rol drejtues në administratën

njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	publike në nivel lokal dhe qëndror, në organizata ndërkombëtare, akademi, institute etj. Diploma master i shkencave në “Etika dhe Liderhipi”, jep mundësi për të vazhduar studimet në programe të tjera të ciklit të tretë. <i>Annex Nr 2.4 Plani strategjik për zhvillimin e programit</i> <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit2023-2024</i> <i>Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit_organized</i> https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/programet.php?fakulteti=fshnh&tipi=msh&programi=filsoc
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Lëndët, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, ashtu sikundër janë specifikuar në planin mësimor mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Studimet në këtë program ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale minimumi 2 vite akademike dhe realizohen me 120 kredite, i strukturuar në dy semestra çdo vit, me nga 30 kredite secili semester. Përveç lëndëve bazë, ofrohen edhe njohuri të thelluara, duke siguruar një përgatitje të mirë në disa drejtime të përshtatshme për nivelin 7 në kornizën kombëtare dhe Evropiane të kualifikimeve. Rëndësia e lëndëve metodologjike si dhe ngarkesa me 18 kredite e Mikrotezës së Diplomës i aftëson dhe përgatit studentët për vijueshmërinë e mëtejshme në studime të ciklit të tretë, doktoraturës. <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit2023-2024</i> <i>Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit_organized</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit	Programi i studimit master i shkencave në “Etika dhe Liderhipi” është hartuar në bazë të kriterëve dhe standarteve të ciklit të dytë të studimeve duke kombinuar lëndë të formimit metodologjik bazë, grup-lëndësh karakterizuese dhe lëndët me zgjedhje, ato plotësuese dhe detyrimet përmbyllëse. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formues dhe sipas përcaktimeve ligjore, duke kategorizuar veprimtaritë formuese, ku peshën kryesore e kanë lëndët/ modulet karakterizuese, të cilat janë tërësisht në përputhje me profilin e programit. Lëndët dhe modulet që ai përmban dhe emërtimi i tyre janë në përputhje me drejtimin dhe profilin e studimit për ciklin e dytë të studimeve. Ky program studimi është në përputhje me programet të ngjashme



të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetencë dhe formim të thelluar profesional.	dhe praktikat të mira kombëtare dhe ndërkombëtare që zhvillohen nëpër universitetet të ndryshme. <i>Annex Nr 2.4 Plani strategjik për zhvillimin e programit</i> <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2023-2024</i> <i>Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit _organized</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive të formues dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet	Ndarja e ngarkesës është relativisht e përshtatshme për këtë program studimi dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese dhe lejojnë transferimin e krediteve/ studimeve. Njohuritë e natyrës teorike dhe kombinimi me aftësimin praktik në këtë program u japin studentëve kompetencë, aftësi profesionale dhe personale që përshtaten me kërkesat e pozicioneve të punës në atë çfarë kërkohet sot nga tregu i punës. <i>Annex Nr 2.4 Plani strategjik për zhvillimin e programit</i> <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2023-2024</i> <i>Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit _organized</i>




dhe punësim në përfundim të studimeve.	
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Programi i studimit është në gjuhën shqipe, por në syllabuset e lëndëve ka literaturë të rekomanduar në gjuhën angleze, e cila mundëson përdorimin e literaturës të përditësuar nga autorët dhe shtëpi botuese akademike ndërkombëtare. Programet e lëndëve mbështeten në kombinimin e literaturës dhe leksioneve të shkruara nga pedagogët. Syllabuset përditësohen çdo vit, pjesa e literaturës së syllabuseve kërkon vëmendje të veçantë, veçanërisht përsa i përket viteve të botimit të literaturës. <i>Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit_organized</i> <i>Annex Nr 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të	GVJ bazuar në takimet e realizuara me stafin akademik, me studentët e programit të studimit dhe me drejtuesit e departamentit, si dhe shqyrtimin e dokumentacionit të programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve, vlerëson se përmbajtja e programit të studimit garanton cilësinë dhe përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Synimi i programit lidhet ngushtë me përgatitjen profesionale të studentit dhe nevojat e sektorit publik e jopublik për analiza të politikave të lidhura me zhvillimin e qendrueshëm ekonomik. Programi i studimit lejon specializimin e thelluar të studentit në drejtim të kompetencave në fushën institucionale të administrimit publik, menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësive të drejtimit duke zhvilluar bazën teorike me elementë të aplikimit në situata praktike në lëndët e formimit të përgjithshëm dhe të specialitetit, por dhe praktikën dhe punën për realizimin e punimit të diplomës.




synuara.	Programi ofron njohuri metodologjike, si aftësi dhe njohuri për të aplikuar në mënyrë kritike instrumentet metodologjike të kërkimit, duke përfshirë aftësinë për të planifikuar dhe kryer hulumtime të pavarura. <i>Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit_organized</i> <i>Annex Nr 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i> <i>Annex Nr 2.4 Plani strategjik për zhvillimin e programit</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ pas takimeve me stafin akademik, me studentët e programit të studimit, me drejtuesit e departamentit, dhe me përfaqësues të zyrës së karrierës dhe alumnit sikurse edhe pas shqyrtimit të programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve, vlerëson se përmbajtja e programit të studimit pajis studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale me profilizim në fushën e etikës, menaxhimit, të drejtës, ekonomisë etj e cila mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Ky program studimi master i shkencave e mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve. <i>Annex Nr 2.7 Plani mësimor i programit të studimit_organized</i> <i>Annex Nr 2.8 Programet lëndore të programit të studimit</i> <i>Annex Nr 2.4 Plani strategjik për zhvillimin e programit</i>
Konkluzione	GVJ bazuar në takimet e realizuara me drejtuesit e institucionit, me stafin akademik, me studentët e programit të studimit, dhe shqyrtimin e dokumentacionit të programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve, vlerëson se përmbajtja e programit të studimit pajis studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale me profilizim në fushën e etikës dhe lidërsipit dhe mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Lëndët, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, ashtu sikundër janë specifikuar në planin pësimor mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor. Studimet në këtë program ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale minimumi 2 vite akademike dhe realizohen me 120 kredite, i strukturuar në dy semestra çdo vit, me nga 30 kredite secili semestër. Përveç lëndëve bazë, ofrohen edhe njohuri të thelluara, duke siguruar një përgatitje të mirë në disa drejtime të përshtatshme për nivelin 7 në kornizën kombëtare dhe Evropiane të kualifikimeve. Rëndësia e lëndëve metodologjike si dhe ngarkesa me 18 kredite e Mikrotezës së Diplomës i

	aftëson dhe përgatit studentët për vijueshmërinë e mëtejshëm në studime të ciklit të tretë, doktoraturës.			
Shkalla e përmbyshjes së standardit	Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbyshjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Institucioni siguron që gjatë hartimit dhe përmirësimit të programit të studimit, propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës të merren në konsideratë. Në shqyrtimin e dokumentacionit dhe bisedat me drejtuesin e departamentit përmenden se marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private i kanë mundësuar departamentit të informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për njohuri, kompetenca që krijohen dhe ndryshojnë herë pas here. Departamenti (drejtuesi dhe koordinatori) organizon në kuadrin e aktiviteteve institucionale aktivitete të përbashkëta si takime me partnerët apo me përfaqësues të pushtetit vendor si Bashkia Korçë, Prefektura, Zyra rajonale e punës, OSHC apo biznese ku zhvillohen praktikantët e studentëve. <i>Annex Nr 3.27 Analiza vjetore e punës FSHNSHH për 2 vite</i> <i>Annex Nr 3.12 Studim tregu pune periodik në kuadër hapje programi</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të	Universiteti bazohet në parimin “Studenti në qendër”. Këshilli Studentor bashkëpunon me Senatin Akademik, për hartimin e strategjisë së çështjeve studentore. Studentët mund të shprehin mendimin e tyre përmes Këshillit të studentëve, vlerësimit të studentëve, peticioneve, kanë akses direkt tek drejtuesi i Departamentit, Dekani dhe Rektori për çështjet e mësimdhënies. Për çdo vit akademik dhe semestër, hartohen pyetësorë për studentë, me qëllim që të merret mendimi i tyre, për përmirësim të mëtejshëm të programit të studimit. Studentët japin mendimin e tyre për metodat e mësimdhënies, materialet e mësimdhënies, mënyrën e vlerësimit etj. Mendimet dhe vlerësimet e studentëve

përmirësimin të programit të studimit.	aktuale dhe të diplomuar, merren në konsideratë në analizën e vjetore të punës të departamentit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Annex Nr 1.1 Statuti i UK Annex Nr 2.2 Rregullorja e njësisë kryesore Annex Nr 3.8 Analiza vjetore e veprimit të njësisë bazë Annex Nr 3.13 Pyetesor studentor
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Për programin e studimit master i shkencave në “Etika dhe Liderhipi” DSHS ka kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore që t’i përgjigjet kërkesave dhe nevojave për përshtatjen e programit që ti përgjigjet nevojave nga institucionet publike e private në nivel qëndror e lokal, në fushat e ekspertizës që mbulon ky program. Departamenti i Shkencave Sociale ka organizuar takime me përfaqësues të institucioneve vendore, OJF, shoqata, biznese etj, me qëllim gërshetimin e teorisë me praktikën. Institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshesh për zhvillimin e praktikës profesionale dhe mban kontakt të vazhdueshëm me këto institucione për kërkesat që ato kanë për punësim në profilin e programit. UniKO ka bazën rregullative për një proces të mirëorganizuar për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Ajo përfshin detaje rreth bashkëpunimit me partnerët dhe monitorimit të progresit të studentëve, duke siguruar që programi të përputhet me zhvillimet e fundit dhe nevojat e tregut të punës. Annex Nr 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO.pdf Annex Nr 2.4 Plani strategjik për zhvillimin e programit Annex Nr 2.12 procedura e ndryshim në planin mesimor Annex Nr 3.8 Analiza vjetore e veprimit të njësisë bazë
Konkluzione	<i>Institucioni merr në konsideratë propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës për përmirësimin e programit të studimit. DSHS ka zhvilluar takime me përfaqësues të institucioneve publike vendore, OJF, biznese, duke nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi që ndihmojnë në përshtatjen e programit me kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Universiteti ka struktura të dedikuara si Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimin Institucional, të cilat përfshijnë studentët dhe të diplomuarit në diskutimet për përmirësimin e programit të studimit. Këshillat studentore në nivel fakulteti dhe institucioni janë aktive në konsultimet për përmirësimin e kurrikulës, duke reflektuar nevojat dhe sugjerimet e tyre në programin e studimit.</i> <i>DSHS përmirëson dhe përditëson programin e studimit në</i>




	përputhje me zhvillimet e fundit dhe propozimet nga institucionet vendore, kompani, shoqata dhe biznese. Departamenti bën një analizë të hollësishme përmes debateve, të cilat konkretizohen me vendimet përkatëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ gjykon se objektivat dhe prioritetet e këtij program studimi të përcaktuara në planin strategjik i zhvillimit të këtij programi masteri shkencor janë në përshtatje të plotë me planin e zhvillimit strategjik të UNIKO dhe të FSHNSHH sikurse reflektohet në dokumentacionin referues dhe nga bisedat me drejtuesit e institucionit dhe stafin akademik. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet në përputhje me misionin dhe qëllimin e UNIKO, aftësimin dhe edukimin e profesionistëve të ardhshëm me njohuri bashkëkohore që t'i përgjigjen kushteve të reja të zhvillimit të kontekstit kombëtar, rajonal e global. Disa nga objektivat lidhen me formimin e profesionistëve me njohuri për rritjen e nivelit akademik në fushën e etikës dhe lidershit, aftësitë dhe njohuritë e thelluara teorike e shkencore për një karrierë të suksesshme profesionale dhe akademike. Me aftësi të vendimmarrjes, komunikimit dhe drejtimit, duke u përqëndruar në ndikimin e etikës profesionale, me njohuri mbi bazat e së drejtës në institucionet e një shteti demokratik. <i>Annex Nr 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO.pdf</i> <i>Annex Nr 2.4 Plani strategjik për zhvillimin e programit</i> <i>Annex Nr 3.8 Analiza vjetore e veprimit të njesisë bazë</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë	GVJ nga bisedat me stafet drejtuese të FSHNSHH dhe DSHS vlerëson se ata inkurajojnë stafin që të angazhohet, jo vetëm në aktivitetet e mësimdhënies, por edhe në aktivitetet me karakter shkencor, social, kulturor. Njësia bazë, në bashkëpunim me njësitet të IAL-së, garantojnë dhe mundësojnë bashkërendimin e veprimtarisë akademike të personelit, duke u bazuar në parimet dhe praktikat më të mira të arsimit evropian. Autonomia akademike konsiston në alternimin e formave të ndryshme në mësimdhënie, si: leksione të hapura nga lektorë të huaj/vendas, përfaqësues biznesesh ose

akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	institucionesh; vizita mësimore pranë bizneseve/institucioneve. <i>Annex Nr 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë të njësisë bazë.</i> <i>Annex Nr 4.8 Tabela e të dhënave për kualifik dhe kërkim shkencor</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	GVJ bazuar në takimet e realizuara në institucion me stafin e departamentit dhe studentët vlerëson se programi i studimit mundëson përgatitjen në lëndë të veçanta të detyrave të kursit ose projekteve të cilat prezantohen nga studentët gjatë orëve të leksionit në auditor. Programi i studimit mundëson dhe nxit studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore në bashkëpunim me pedagogët e tyre. Gjithashtu, studentët bëhen pjesë e vizitave studimore dhe kërkimore pranë institucioneve të caktuara në përputhje me tematikën e lëndës, organizuar këto nga stafi i DSHS. Po ashtu, finalizimi i temave të diplomave me supervizimin e profesorëve të departamentit, përbën një tregues të angazhimit dhe mbështetjes së studentëve për kërkimin shkencor. <i>Annex Nr 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë të njësisë bazë.</i> <i>Annex Nr 4.8 Tabela e të dhënave për kualifik dhe kërkim shkencor</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për kërkimin shkencor, institucioni ofron lloje të ndryshme stimuljsh për stafin akademik që të përfshihen në kërkimin shkencor dhe në aktivitete të ndryshme studimore. Kërkimi shkencor mbështetet financiarisht në disa mënyra si mbështetja financiare për realizimin e konferencës vjetore ku lektorët e DSHP përfshihen; nëpërmjet mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare apo për financimin e publikimeve në revista ndërkombëtare (në vlerën 40.000 për pedagog). Financimi nuk është shpërblim për kërkimin e realizuar por rimbursim i kostove për pjesëmarrje në konferencë ndërkombëtare apo për botimin e një artikulli në revistë shkencore. <i>Annex Nr 2.18 Vendimi i bordit të administrimit dhe senatit të UNIKO</i> <i>Annex Nr 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë të njësisë bazë.</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor si për stafet akademike edhe studentët e këtij masteri shkencor. Kërkimi shkencor mbështetet financiarisht nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjes në konferencën e fakultetit, nëpërmjet fondit institucional për financimin e publikimeve në revista ndërkombëtare (40.000 për pedagog). UNIKO inkurajon dhe mbështet financiarisht pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet

	<i>mbulimit të kostove financiare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	FSHNSHH dhe DSHS mbështesin dhe inkurajojnë bashkëpunimet duke organizuar aktivitete kërkimore-shkencore si konferenca, aktivitete ekstra-kurrikulare (leksione të hapura/ëorkshop-e/seminare). Po ashtu, gjatë bisedës me stafin akademik, GVJ konfirmon se Departamenti dhe njësitë përgjegjëse japin hapësirë për angazhim në kërkime shkencore dhe bashkëpunime në kuadër të projekteve të financuara nga AKKSHI dhe institucione të tjera për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. <i>Annex Nr 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë të njësisë bazë.</i> <i>Annex Nr 3.25 Dosje e leksioneve, aktiviteteve</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësitë përgjegjëse si departamenti dhe njësia e kërkimit dhe projekteve informojnë stafin akademik dhe studentët për thirrjet e mobiliteteve, mundësi për kryerjen e studimeve dhe analizave dhe i inkurajon ata të aplikojnë. Konkretisht ka pjesëmarrje aktive në projektet Erasmus si nga stafet akademike edhe studentët me mobilitete (1 staf akademik; 4 staf administrativ dhe 3 studentë). Këto anagzhime institucionale reflektohen dhe në dokumentet strategjike të UNIKO, FSHNSHH dhe DSHS, sikurse edhe në partneritet me aktorët e tjerë duke ofruar shërbime në fushat respektive të ekspertizës. <i>Annex Nr 4.13 lista e aktiviteteve bashkp ne kuader te mobiliteteve</i> <i>Annex Nr 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë të njësisë bazë.</i> <i>Annex Nr 3.25 Dosje e leksioneve , aktiviteteve</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit.</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia	Nga shqyrtimi i faqes online të UNIKO dhe takimet në institucion me stafet akademike e studentët, rezulton se

përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	FSHNSHH dhe DSHS organizojnë një sërë aktivitete me karakter shkencor dhe mësimor, duke inkurajuar stafin dhe studentët të bëhen pjesë e tyre. Përfshirja e tyre në programin Erasmus dhe konferencat e ndryshme, organizimin e aktiviteteve ekstra-kurrikulare aftësojnë me tej personelin në drejtim të mësimdhënies dhe rritjen e aktiviteteve kërkimore. <i>Annex Nr 4.13 lista e aktiviteteve bashkp ne kuader te mobiliteteve</i> <i>Annex Nr 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë të njësisë bazë.</i> <i>Annex Nr 3.25 Dosje e leksioneve, aktiviteteve</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit akademik. Kontributi i këtij programi të ndryshuar ka qenë përgjigja ndaj kërkesës në rritje për njohuri etike dhe lidërshipi për menaxher dhe drejtues me njohuri bashkëkohore si nga sektori publik ashtu edhe nga ai privat, ku kanë pasur mundësi punësimi edhe studentët. <i>Annex Nr 2.5 Rregullore e programit të studimit 2023-2024</i> <i>Annex Nr 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë të njësisë bazë.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nuk aplikohet
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Nuk aplikohet




Konkluzione	GVJ vlerëson se UNIKO, FSHNSHH dhe DSHS kanë reflektuar në dokumentet strategjike dhe kanë aplikuar mbështetje për ofrimin e njohurive të thelluara përmes zëvendësimit të programit të mëparshëm të masterit, kanë inkurajuar ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor. Këto janë realizuar si duke organizuar aktivitete kërkimore-shkencore si konferenca, workshop-e, seminare, dhe përfshirje në projektet të BE si Erasmus në mobilitetet për stafin efektiv të departamentit dhe studentët. Po ashtu gjatë bisedës me stafin akademik, GVJ konfirmon se Departamenti dhe njësitë përgjegjëse japin hapësirë për angazhim në kërkime shkencore dhe bashkëpunime në kuadër të projekteve të financuara nga AKKSHI dhe institucione të tjera për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Programi i studimit krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI E KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe	IAL si edhe Fakulteti i Shkencave Natyre dhe Shkencave Humane zhvillojnë veprimtarinë e tyre si në procesin mësimor adhtu edhe në kërkimin akademik në përputhje me percaktimet ligjore dhe




transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	normat nënligjore në fuqi. Si pjesë e Departmentit të Shkencave Sociale programi përpiqet të harmonizojë metodat bashkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive, të cilat janë të përcaktuara në çdo syllabus. Leksionet harmonizohen me një diskutim aktiv, punë në projekte individuale por edhe në grupe si edhe zhvillimin dhe nxitjen e mendimit kritik për të nxjerrë në pah përmbushjen e objektivave mësimore nga ana e studentëve. Kjo arrihet duke zhvilluar analiza mbi papers, ese apo artikuj të marra nga literatura shekncore. Për të siguruar një rezultat sa më të lartë në mësimnxënie pedagogët ofrojnë një larmi mënyrash siç janë projektet në grupe, prezantimet individuale apo video prezantuese. Këto forma janë mbështetur edhe me infrastrukturën përkatëse në nivel insitucional pasi tek universiteti FAN NOLI funksionon platforma online “Office 365 for education” e krijuar gjatë pandemisë, ndërsa vazhdon ta shfrytëzojë infrastrukturën e krijuar për të diversifikuar format e mësimdhënies dhe mësimnxënies, por edhe për administrimin e të dhënave të programit online. Ndonëse, ka një praktikë profesionale të përfshirë në këtë program stafi i programit organizon vazhdimisht orë të hapura duke sjellë në auditor perfaqësues të stakeholders të rëndësishëm për të ofruar sa më shumë studentët me problematikat dhe tematikat reale. Megjithatë GVI vuri në dukje se praktika duhet të jetë më e profilizuar për ti bërë të mundur studentëve që të specializohen në fushat përkatëse të etikës dhe lidërsip dhe jo vetëm të kryejnë praktikën në një sërë institucionesh publike me një sistem rotacioni dhe periudhë të përcaktuar në secilin prej tyre. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që praktika të jetë sa më efektive duke i drejtuar studentët drejt tregut të punës. Annex Nr. 2.8- Programet lëndore të programit të studimit Annex Nr. 2.5- Rregullorja a programit të Studimit Link 5.2 http://www.unkorce.edu.al/integrimi-gjinor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-sesion-informues-me-qellim-informimin-mbi-kuptimin-rendesine-dhe-perfitimet-qe-sjell-integrimi-gjinor-dhe-monitorimin-e-te-dhenave-me-ndj/ Link 5.3 http://www.unkorce.edu.al/te-thyejme-se-bashku-mitin-e-mosndeshkimit-te-korrupsionit-forum-i-hapur-i-organizuar-nga-fakulteti-i-shkencave-te-natyres-dhe-shkencave-humane-ne-bashkepunim-me-komitetin-shqiptar/ Link 5.4 http://www.unkorce.edu.al/universiteti-fan-s-noli-ne-
---	---

	<u>kuader-te-muajit-te-gruas-zhvilloi-nje-veprimtari-ndergjegjesuese-ne-lidhje-me-permiresimin-e-situates-mbi-respektimin-e-lirive-dhe-te-drejtave-t/v/</u> Link 5.5 http://www.unkorce.edu.al/universiteti-fan-s-noli-ndergjegjesim-ne-diten-nderkombetare-te-edukimit-mbi-rolin-dhe-rendesine-e-tij-per-gjithe-shoqerine/ Link 5.6 http://www.unkorce.edu.al/me-qellim-promovimin-e-perfshirjes-se-te-rinjve-ne-vendimmarrje-levizja-mjaft-zhvilloi-nje-takim-me-studente-te-universitetit-fan-s-noli/ Link 5.7 http://www.unkorce.edu.al/ambasadori-i-austrise-ne-tirane-dr-christian-steinar-zhvilloi-nje-leksion-te-hapur-me-studente-te-fakultetit-te-shkencave-natyrore-dhe-shkencave-humane-me-teme-austria-ne-bashkimin-evropia/ Link 5.8 http://www.unkorce.edu.al/te-drejta-te-barabarta-per-te-gjithe-takim-i-organizuar-me-stuente-te-fshnh-nga-organizata-futural-ngo-ne-bashkepunim-me-departamentin-e-shkencave-sociale
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Harmonizimi i metodave të mësimdhënies nga personeli akademik duke gërshetuar leksionet online me platformat online, në varësi të specifikave të programit janë të pasqyruara edhe në Planin Strategjik të zhvillimit të Universitetit i cili parashikon si prioritet ofrimin e një mjedisi cilësor për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Si një nga tre shtyllat kryesore të strategjisë institucionale, përparësi i jepet evidentimit të metodave dhe metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe ofrimit të metodologjive sa më inovative siç është programi Clean Score, si një alternativë dixhitale në këtë drejtim. Një praktikë pozitive është organizimi i mësimin pas orës 15:00 për t’iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të studentëve shumica e të cilëve janë në marrëdhënie pune. Studentët marrin pjesë në aktivitete kërkimore dhe shkencore të organizara nga stafi akademik, por edhe kanë mundësinë e pjesëmarrjes në leksionet e hapura me pedagogë të ftuar nga institucione vendase dhe të huaja. Annex Nr. 1.3- Plani Strategjik i Zhvillimit të UNMKO 2022-2027 Annex Nr. 3.16- Raporti i Aplikimit të projektit CleanScore Annex Nr. 2.5- Rregullorja e Programit të Studimit Annex Nr. 3.22- Raport mbi korrijimin e automatizuar të provimeve Annex Nr. 68- Manual i sisteimit elektronik Pitagora
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin	Universiteti Fan Noli organizon trainime të rregullta vjetore për stafin akademik dhe bashkë me departamentin përkatës



akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	mbështesin rritjen e nivelit profesional, si edhe përhapjen e metodave të suksesshme mësimore ndërmjet stafit akademik, duke synuar rritjen e vazhdueshme profesionale të pedagogëve dhe ofrimin e stimuljeve për përmirësimin profesional. Për këtë qëllim organizohen: a) aktivitete shkencore nga FSHNSHH si edhe aktivitete shkencore dhe workshope në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, ku pedagogët nxiten që të paraqesin punimet e tyre shkencore; b) nxitet pjesmarrja në procesin e botimeve shkencore; c) programeve të bashkëpunimit partnerë ndërkombëtare dhe vecanerisht ne Erasmus Mundus. Për të përmirësuar cilësinë e punës së pedagogeve me format e reja të edukimit dixhital, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ka ngurtuar një strukturë të posaçme. Annex No. 1.1- Statuti i Universitetit “Fan Noli” Kreu V, neni 40, pika 2. Annex No. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan Noli”, Kreu 5, neni 28, pika 4.. Link 5.10 Link 5.11 https://docplayer.net/76555299-Didaktika-e-shkencave-2017.html Link 5.12 http://www.unkorce.edu.al/kerkimi-shkencor-aplikimi-dhe-metodat-ne-edukim-konferenca-ii-nderkombetare-e-zhvilluar-nga-universiteti-fan-s-noli-korce-ne-bashkepunim-me-universitetin Link 5.13 Link 5.14 http://www.unkorce.edu.al/ne-universitetin-fan-s-noli-u-zhvilluan-trajnime-per-stafin-akademik-dhe-ndihmesakademik-ne-kuader-te-projektit-bologna-hub-peer-support Link 5.15 http://www.unkorce.edu.al/afesite-ne-drejtimit-ishin-ne-qender-te-nje-trajnimi-qe-u-zhvillua-ne-mjediset-e-rektoratit-me-trajnere-te-programit-te-detyrueshem-pergatitor-per-drejtues-te-institucioneve-te-arsimit-parauniversitar Link 5.16 http://www.unkorce.edu.al/u-zhvilluan-ne-universitetin-fan-s-noli-trajnime-per-stafin-akademik-dhe-ndihmesakademik-ne-lidhje-me-publikimet-shkencore/ Annex Nr. 1.3- Plani Strategjik i Zhvillimit të UNMKO 2022-2027 Annex Nr. 2.4- Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program	Diplomimi i disa prej pedagogëve të departamentit ku bën pjesë programi jashtë vendit, por edhe e eksperiencës së përfituar në mësimdhënie që ka një pjesë e tyre, natyrisht që ndihmon jo

është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	vetëm i cilësinë profesionale të tyre, por edhe lejon programin që të përfitojë nga metodat bashkëkohore të mësimdhënies që ata sjellin. Network që këta pedagogë sjellin nga këto eksperiencia favorizon bashkëpunimin e mëtijshëm si në kuadër të programeve specifike në mësimdhënie, çka fillon me kërkesat e larta profesionale në procesin e rekrutimit, ku departamenti konsideron: a) përvojën mësimore dhe shkencore në fushën përkatëse; b) publikimet shkencore të realizuara; c) gradën shkencore dhe titullin akademik. Më tej vlerësimi i pedagogut bëhet edhe nëpërmjet një leksioni të hapur. Ndarja e lëndëve bëhet duke patur parasysh ekspertizën dhe specializimin e pedagogut. Kompetencat e stafit akademik janë rritur më tej edhe falë pjesëmarrjes në projekte kërkimore dhe të mësimdhënies me partnerë të huaj. Shumica e pedagogëve kanë marrë pjesë në programet Erasmus+ fokusuar në përmirësimin e kurrikikulave apo metodave të mësimdhënies. Annex Nr. 2.5- Rregullore e Programit të Studimit Annex Nr. 1.3- Plani Strategjik i Zhvillimit të UNMKO 2022-2027 Annex Nr.1. 14- Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit Annex Nr. 2.16- Formati i Dosjes Personale Mësimore të Stafit Annex Nr. 93- Tabelat Përmbledhëse Annex No. 1.1- Statuti i Universitetit “Fan Noli” Kreu V, neni 40, pika 2.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	IAL përdor mekanizma periodike vlerësimi për përmirësimin e mësimdhënies nga instancat e ndryshme të cilat mund të pëmrblidhen në: a) Vlerësimi i raporteve të cilësisë së hartuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ky proces kryhet duke u bazuar në analizat periodike të personelit akademik, anketat e vlerësimit të lëndës, kontrolli i cilësisë së syllabuseve, harmonizimin e ngarkesës së stafit akademik; ndihmën që i ofrohet stafit të ri, trainimit per përgatitjen e kurrikulave akademik, vlerësimi i performancë së stafit akademik, etj; b) Vlerësimi nga studentët është një tjetër formë e cila synon dhënien e sugjerimeve për përmirësimin e cilësisë.; c) vlerësimi i pedagogëve me eksperiencë për pedagogët e rinj Kjo praktikë është veçanërisht ndihmuese për pedagogët e rinj; d) pedagogu i kërkon studentëve nëpërmjet një formati të lirë dhe në mënyrë anonime që të shprehen lidhur me pikat e dobëta apo të sugjerojnë rrugë për përmirësimin e punës së pedagogut. Në këtë mënyrë, ky

	vlerësim jo vetëm që vë në dukje aspekte që kanë nevojë për përmirësim por ofron edhe sugjerime konkrete se si mund të përmirësohen më tej këto dobësi. Raportet e vlerësimit dhe analizat e përgatitura analizohen dhe vihen në dispozicion pedagogëve ndërsa shërbejnë për të hartuar politikat përkatëse për përmirësimin e punës. <i>Annex Nr. 1.5- Rregullorja e Drejtorise se Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional</i> <i>Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së UNMKO</i> <i>Annex Nr. 31- Course Instructor Evaluation Survey</i> <i>Annex Nr. 3.13- Format aport mbi pyetësorin e studentëve</i> <i>Annex Nr. 3.7- Raportet vjetore te NJSBC</i> <i>Annex Nr. 3.8- Analiza vjetore e veprimtarisë së njësive bazë</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Përveç integritetit të strukturave në nivel universiteti nga fakultetet si njësitë kryesore dhe njësitë bazë departamentet, që kordinojnë punën me qendrat kërkimore shkencore, IAL ka disa struktura bazë për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies: 1) Njësia Sigurimit Bazë të cilësisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e këtij niveli duke përdorur një sërë mekanizmesh; 2) Drejtoria e Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional; 3) Drejtoria e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor; 3) Qendra Ndërdisciplinare e Kërkimit Shkencor. Vlerësimet e studentëve kryhen në bazë të një lënde të një kursi dhe administrohen çdo semestër. Duke ofruar sugjerime – si nëpërmjet pyetësorëve por edhe shkëmbimeve të drejtëpërdrejta me pedagogët - studentët ndihmojnë jo vetëm në vlerësimin e cilësisë së punës së pedagogut, por edhe përfshihen në përmirësimin e programit të studimit. Vlerësimet dhe raportet e lartpërmendura të pedagogëve i dërgohen drejtuesit të departamentit, i cili ia dërgon Dekanit dhe më pas tek Senati Akademik i cili është organi më i lartë drejtues i IAL dhe mbështetet nga organe të tjera sic janë Asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme shkencore. Universiteti Fan Noli ofron aktivitete vjetore trainimi për pedagogët – sidomos për pedagogët e rinj - duke u bazuar mbi nevojat që ata paraqesin, në planin/objektivat e punës në procesin e mësimdhënies, dhe propozimet e ardhura nga studentët. <i>Annex No. 1.1- Statuti i Universitetit “Fan Noli” Kreu V dhe Kreu II, neni 5, 6, 7, 8, 9, 10, neni 18, pika 19.</i> <i>Annex No. 1.1- Statuti i Universitetit “Fan Noli” Kreu II, neni</i>



	31 Annex Nr. 1.5- Rregullorja e Drejtorise se Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional Annex Nr. 1.21- Rregullore për standartet dhe rregullat e përfitimit të së drejtës për vitin sabbatik Annex Nr.18- Procedura e Ndryshimeve në Planin mësimor (rishikimi i kurrikulës)			
Konkluzione	<i>Institucioni harmonizon një seri formash të mësimdhënies dhe mësimxënies, falë ekperiencës së pedagogëve dhe punës që bëhet për trainimin dhe zbatimin e praktikave të përparuara për përmirësimin e punës së pedagogëve. Këta të fundit përballen me disa forma vlerësimi, si nga studentët edhe nga strukturat e sigurimit të cilësisë për të matur progresin e arritur në integrimin e formave sa më të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimxënies.</i> <i>Një praktikë pozitive është organizimi i mësimin pas orës 15:00 për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të studentëve shumica e të cilëve janë në marrëdhënie pune.</i> <i>Pothuajse i gjithë stafi ka marrë pjesë në projektet Erasmus+ për të përmirësuar më tej kompetencat si në fushën e mësimdhënies ashtu edhe në atë kërkimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe	Në Rregulloret e Universitetit, Njesisë Kryesore dhe atë të Njesisë Bazë për programet e studimit të Ciklit të Dytë - përcaktohen kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve. Mënyra e vlerësimit të studentëve pasqyrohet brenda planit të lëndëve dhe në syllabuset e çdo lënde, ku në një seksion të vecantë paraqiten kriteret e vlerësimit për lëndën. Institucioni ka një formë të miratuar me karakteristikat kryesore të vlerësimit për programet bachelor dhe master por pedagogu i lëndës ka të drejtën e përshtatjes së tyre për një vlerësim sa më të efikas të lëndës.



njihen nga studentët.	Në përgjithësi lëndët vlerësohen duke patur parasysh shpërndarjen e aktiviteteve të ndryshme akademike sic janë, provimet detyrat e kursit, quiz, studime në terren, projekte kërkimore, punë në grup të cilat i bashkangjiten provimit apo projektit përfundimtar të lëndës. Në javën e fundit të mësimdhënies, pedagogu bën një përmbledhje të lëndës dhe i informon studentët në lidhje me karakteristikat e provimit. Studentët informohen mbi këto rregullore dhe mund ti shqyrtojnë në çdo moment. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 76-87.</i> <i>Annex Nr. 2.2- Rregullore e Njesisë Kryesore</i> <i>Annex Nr. 2.3- Rregullorja e Njesisë Bazë</i> <i>Annex Nr.2.7- Plani Mësimor i Programit të Studimit.</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët e programit njihen me syllabusin dhe të gjithë elementët e tjerë të kursit, gjatë orës së parë të zhvillimit të lëndës apo modulit, si një detyrim institucional i përcaktuar në të gjitha rregulloret e lartpërmendura. Këtu përfshihen edhe informacionet lidhur me mënyrën e testimit si edhe kriteret e transparencës për një vlerësim sa me objektiv, të cilat mund të testohen edhe online. <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VIII, neni 79.</i> <i>Annex Nr. 2.5- Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Annex Nr.2.7- Plani Mësimor i Programit të Studimit.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në përgatitjen e formave të testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentit harmonizohen karakteristikat e lëndës dhe zgjedhja që pedagogu konsideron si më të përshtatshmen për këtë qëllim, të cilat janë të përcaktuara në Planin e Lëndës. Në këtë program mënyrat më të frekuentuara të kontrollit të mësim-nxënies janë një harmonizimin i punimeve individuale, aktivitetet gjate kursit siç janë prezantimet, projektet individuale ose në grup, quizet, punimet laboratorike dhe provimi përfundimtar. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve bëhet sipas modelit të detajuar (model teze) gjithsej 100 pikë. Studentët kanë mundësi të njihen në detaje me kërkesat e formave të vlerësimit të përdorura dhe të bejnë pyetje sqaruese në rast se është e nevojshme. Ata kanë gjithashtu edhe mundësinë e ankimimit apo sugjerimeve për përmirësime të mëtejshme.



	<i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 76-87.</i> <i>Annex Nr. 2.2- Rregullore e Njesisë Kryesore Kreu IV</i> <i>Annex Nr. 2.3- Rregullorja e Njesisë Bazë</i> <i>Annex Nr.2.7- Plani Mësimor i Programit të Studimit</i> <i>Annex Nr. 1.6- Manual i Sistemit Elektronik Pitagora</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive duke gërshetuar punën kërkimore gjatë kursit me provën përfundimtare. Zbatimi i këtyre procedurave të testimit të dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore garantohen si nga stafi akademik ashtu edhe ai ndihmës, siç është stafi i IT.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Rregullorja e departamentit percakton parimet e kriterëve të vlerësimit për kursin, si edhe tabelën e vlerësimit të notave brenda kornizave kohore të dedikuara sipas karakteristikave të lëndës. Pavarësisht specifikave të lëndës apo fokusit të pedagogut në vlerësimin e komponentëve të caktuar, tesimi i njohurive bëhet gjatë të gjithë kursit duke u bazuar mbi elementë të ndryshëm siç janë pjesmarrja aktive, përgatitja e projekteve apo prezantimeve. Kjo shihet edhe në shpërndarjen e vlerësimit përfundimtar në disa zëra, çfarë përcaktohet qartë në rregullore duke u harmonizuar me kërkesat e lëndës, dhe konkretisht: a) detyra specifike sipas llojit të lëndës; b) provimi përfundimtar apo detyra kursi (që mund të jetë edhe një prezantim); c) pjesmarrje aktive gjatë periudhës së zhvillimit të lëndës. Kjo mënyrë vlerësimi krijon mundësinë për të vlerësuar progresin e arritur nga studentët dhe i mundëson atyre të evidentojnë mangësitë e paraqitura <i>Annex Nr. 2.3- Rregullorja e Programit të Studimit</i> <i>Annex Nr.2.7- Plani Mësimor i Programit të Studimit</i>




	<i>Annex Nr. 3.22-Raport mbi korrigjimin e automatizuar të provimeve</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Provimet zhvillohen si në formatin e printuar ashtu edhe në atë elektronik, pasi institucioni ka vënë në dispozicion të pedagogëve sisteme elektronike të vlerësimit të cilat sigurojnë aksesin e studentëve në informacionin e nevojshëm siç janë notat, frekuentimi etj, por edhe sigurojnë transparencën e vlerësimit dhe shmangin format e mundshme të abuzimit. Të gjitha papers, ese apo të tjera punime të studentëve kalojnë nëpërmjet sistemit për nivelin e plagjaturës që nuk duhet të kalojë 20%, ndërsa provimet zhvillohen në mënyrë anonime dhe studentët shkruajnë vetëm numrin e tyre të ID. <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VIII, neni 79.</i> <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 76-87.</i> <i>Annex Nr. 3.22-Raport mbi korrigjimin e automatizuar të provimeve Annex Nr.2.5- Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Annex Nr. 1.6- Manual i Sistemit Elektronik Pitagora</i> <i>Annex Nr. 1.20- Rregullore e Bordit të Amdinistrimit</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar bëhet duke zbatuar rregulloret dhe kërkesat e syllabusve përkatës për çdo lëndë, dhe rregulloren e insitutucionit dhe zhvillohet duke marrë parasysh vlerësimet e pjesshme dhe ato përfundimtare të secilit element të testimit të lëndës siç u përmend më sipër. Për një transparencë sa më të plotë, përqindjet e vlerësimit për çdo element vendosen në një rubrikë të veçantë të syllabusit, si edhe u shpjegohet studenteve në fillim të çdo lënde. Komisionet e provimeve të përbërë nga dy pedagogë dhe titullari i lëndës ngrihen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani Fakultetit në përputhje me Statutin e Universitetit, rregulloren e provimeve dhe udhëzimin përkatës të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Natyre dhe Shkencave Humane. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 76-87.</i> <i>Annex Nr. 2.2 -Rregullore e Njësisë Kryesore, Kreu IV</i> <i>Annex Nr.2.5- Rregullore e Programit të Studimit</i> <i>Annex Nr. 1.6- Manual i Sistemit Elektronik Pitagora</i> <i>Annex Nr. 2.23- Komisionet e Provimeve DSHS viti akademik 2022-2023.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe	Pedagogët ofrojnë sugjerime dhe feedback për secilin nga elementët e vlerësimit të studentit. Vlerësimit të studentit i



aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	bashkangjitet një feedback nga ana e pedagogut dhe përcillet përmes email apo komunikimit direkt të secilit student me pedagogun për të sqaruar arsyet e vlerësimit, ndërsa studentët inkurajohen që të shprehin ankesat e tyre për vlerësimin. Studentët marrin feedback gjatë gjithë vitit lidhur me përparimin e tyre përsa i takon përputhshmërisë së performancës së tyre akademike me kërkesat e lëndës . <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 76-87.</i> <i>Annex Nr. 2.2 - Rregullore e Njesisë Kryesore, Kreu IV</i> <i>Annex Nr.2.2 - Rregullore e Njesisë Bazë</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Universiteti përcakton në “Kodin e Etikës” dispozitat për shkeljet disiplinore, sic mund të jetë kopja, rastet e plagjiaturës apo format e tjera të mashtrimit, rastet e të cilave trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Ekziston sistemi kundër plagjiaturës, të cilit i nënshtrohen të gjithë punimet e studentëve. Plagjatura sqarohet gjerësisht nga pedagogët për studentët si gjatë kursit, në mënyrë që studentët të informohen se si duhet , çfarë përbën plagjaturë dhe si mund të bëhen citimet e materialeve shkencore. Sikundër u theksua më lart rregulloret në nivelin IAL dhe në nivel programi përcaktojnë masat që marrin pedagogët në mënyrë që proceura e provimit të jetë e pakorruptueshme dhe si të zbatojnë rregulloren e universitetit për të gjithë ata studentë që shkelin etikën akademike. Së bashku me specialistin IT krijohet dritarja përkatëse ku studentët mund të dorëzojnë detyrat e përfunduara. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 89-90.</i> <i>Annex Nr. 2.2 - Rregullore e Njesisë Kryesore, Kreu IV</i> <i>Annex Nr.5.18 - Kodi i Etikës së Universitetit Fan Noli, neni 13</i> <i>Annex Nr.2.14 – Manual për Punimin e Diplomës</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Siç u përmend edhe më lart provimet kryhen në anonimitet të plotë dhe ID krijohet në mënyrë të rastësishme nga zyra e IT për çdo student gjatë semestrit. Ekzistojnë forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive personale të studentëve duke patur parasysh objektivat didaktike të lëndës me një sistem prej 10 notash, ndërsa nota më e ulët kaluese është 5. Këto forma përfshijnë aftësitë analitike të studentëve, ato prezantuese, kapacitetet për të sintetizuar materialin që i vihet në dispozicion dhe promovuar një këndvështrim kritik. Në këtë mënyrë dhe me anë të një testimi të vazhdueshëm të njohurive, vlerësimi me notë i studentit pasqyron kompetencën e studentit në zotërimin e lëndës.



	Rregullorja përcakton afatet e dorëzimit të notave në sekretarinë mësimore – jo më shumë se 8 ditë nga data e provimit përfundimtar - pasi më parë sekretaria ka informuar pedagogët lidhur me këto data, që në fillim të vitit akademik. Në provimet me gojë nota ofrohet direkt pas përfundimit të provimit. Ky informacion është i pasqyruar në kalendarin akademik, i cili publikohet edhe në faqen e internetit të universitetit. Pedagogu ia dorëzon dosjen e provimit përgjegjësit të departamentit pak ditë pas periudhës së provimit përfundimtar dhe në përmbajtje të saj janë të gjitha fletët e provimit, përgjigjet e sakta, një kopje e provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave të përfunduara. Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 76-87. Annex Nr. 2.2 - Rregullore e Njesisë Kryesore Annex Nr.2.3- Rregullore e Njesisë Bazë, Kreu IV Annex Nr. 1.6 - Manuali i Sistemit Elektronik Panmdora Annex Nr.3.16 - Raport i implementimit të projektit Clean Score Annex Nr.3.22- Raport mbi korrigjimin e automatizuar të provimeve
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët njihen me notën përpara se kjo të dorëzohet në sekretari dhe mund të shprehin mendimin e tyre lidhur me vlerësimin si edhe të kërkojnë të takohen me pedagogun për të marrë një arsyetim lidhur me vlerësimin me notë. Studentët kanë të drejtën e ankimit për notën brenda 5 ditëve nga marrja e përgjigjes së provimit pranë pedagogut të lëndës, i cili shqyrton nëse ka patur ndonjë gabim në korrigjimin e provimit, dhe në rast se studenti nuk bindet për argumentimin ka të drejtë të ankohet pranë dekanatit që ngre një komision të posacem vlerësimi. Studentët ndjekin një procedurë të veçantë për ankimet në të gjitha nivelet dhe për të gjitha strukturat duke përfshirë si anën akademike ashtu edhe atë logjistike apo administrative Annex Nr.2.3- Rregullore e Njesisë Bazë
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe	Studentët kanë të drejtë të ankimojnë notën fillimisht me pedagogun e lëndës dhe nëse pedagogu nuk e gjykon me vend të rishikojë notën, atëherë studenti i drejtohet koordinatorit të Departamentit, për të përfunduar më pas me komisionin vlerësues që ngrihet në përputhje me procedurat për këtë ankimim janë të sanksionuara në Rregulloren e provimeve. Procedurat janë transparente dhe mund të ndiqen në çdo hap si nga studenti ashtu edhe nga sekretaria, e cila dokumenton dhe arkivon çdo hap duke përfshirë edhe raportin përfundimtar të aprovuar nga

arkivohet.	dekanati. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 76-87.</i> <i>Annex Nr.2.3- Rregullore e Njesisë Bazë, Kreu IV</i>			
Konkluzione	<i>Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe bëhen transparente që në fillim të vitit akademik si nëpërmjet syllabuseve ashtu edhe sqarimit që bëhet përpara çdo testimi nga ana e pedagogut. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit, i cili sigurohet nga legjislacioni i institucionit. Këto informacione u vërtetuan edhe nga bisedat me studentët edhe stafit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit i ofron studentëve njohuri si të zhvillojnë aftësitë kritike në disiplinat e ndryshme brenda programit të studimit Profili akademik i pedagogëve, bashkëpunimi i tyre në nivel akademik me homologët në aktivitete shkencore ku marrin pjesë edhe studentët krijojnë mundësinë që këto njohuri të mund të pasqyrohen edhe në lëndët përkatëse duke harmonizuar lëndët integruese/ndërdisciplinore me praktikën profesionale (institucionale) dhe mikrotezën në programin didaktik që vihet në dispozicion të studentëve. Azhurnimi i vazhdueshëm i lëndëve me literaturën bashkëkohore por edhe thellimi i kërkimit shkecor individual nga ana e pedagogëve kontribuojnë në këtë drejtim <i>Annex Nr. 2.5- Rregullore e Programit të Studimit.</i> <i>Annex Nr. 2.7 - Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Annex Nr.2.8- Programet lëndore të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Programi i studimit parashikon një harmonizim të njohurive specifike të fushës me ato të mendimit kritik, aspekteve humane, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duke përfshirë këtu edhe gjuhën e huaj. Transmetimi i njohurive tek

informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	studentët kryhet duke përfshirë si njohurive metodologjike ashtu edhe punën konkrete nëpërmjet projekteve individuale ose në grup – për të mbështetur zhvillimin e soft-skills - apo detyrave të kursit për të nxitur zhvillimin e mendimit kritik të studentëve dhe zbatimit në praktikë të këtyre njohurive. Për të arritur një nivel të lartë kërkimi ashtu edhe për prezantimin e punës së kryer, studentët mbështeten tek teknologjia e informacionit (e-library apo format e ndryshme të prezantimit). <i>Annex Nr. 2.5- Rregullore e Programit të Studimit.</i> <i>Annex Nr. 2.7 - Plan i mësimor i programit të studimit</i> <i>Annex Nr.2.8- Programet lëndore të programit të studimit</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Stafi akademik prezanton për studentët Planin e Lëndëve, i cili shpjegon objektivat mësimore, dhe shpjegon të gjitha njohuritë dhe aftësitë që zhvillon studenti, si edhe kompetencat që përfiton gjatë vitit akademik së bashku me aftësitë ndërvepruese të përmendura më lart si për shembull soft-skills apo në teknologjitë e informacionit, analizohen nga pedagogu në përfundim të lëndës apo të semestrit. Në takimin me studentët, GVJ vërejt se kjo analizë e njohurive që duhet të përfitohen por edhe asaj që mbetet ende për tu bërë ndihmon studentët për ti adresuar këto objektiva por edhe sugjerimet e pedagogëve në vijim të studimit akademik. Kjo praktikë u konfirmua edhe në takimin me pedagogët të cilët theksuan se kanë takime të vazhdueshme me studentët dhe në këto konsultime ofrohen sugjerimet përkatëse për përmirësimin e punës me studentët. Megjithatë GVJ vërejt se është e nevojshme një profilizim i mëtejshëm i drejtimeve që i ofrohen studentit si në fushën e etikës ashtu edhe në atë të lidërshipt. Në momentin aktual është me vend që të kalohet nga konceptet e teorike të lidërshipt dhe ato filozofike të etikës që më tepër do të shërbenin si lëndë transversale për formimin e përgjithshëm të studentëve, në fazën e aplikimit të tyre në drejtime konkrete që kërkohen nga realiteti i zhvillimit siç janë për shembull: etika dhe inteligjenca artificiale; etika dhe bioteknologjia; etika e kërkimit shkencor; etika në fushën e shëndetësisë; lidërshipt në nivelin lokal etj. <i>Annex Nr. 2.5- Rregullore e Programit të Studimit.</i> <i>Annex Nr.2.8- Programet lëndore të programit të studimit</i> <i>Takim me Studentët dhe Pedagogët e Programit</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë	Mësimdhënia zhvillohet duke u bazuar në kompetencat që synon të arrijë programi duke u bazuar në dy metodologji




kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	kryesore: teorike dhe praktike. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet, materiali shtesë, literatura e rekomanduar, si edhe informacioni i aksesueshëm. Kjo realizohet falë infrastrukturës në aspektin teorik siç është libraria online, biblioteka apo edhe aksesit që kanë studentët në programe të ndryshme të literaturës. Ndërkohë institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit infrastrukturën e nevojshme për të realizuar në aspektin praktik aktivitete të ndryshme sic janë hulumtimet, diskutimet në grupe ku studentët paraqesin pikpamjet e tyre lidhur me temën që trajtohet dhe interpretimin e tyre mbi njohuritë e marra. Pedagogu sigurohet që diskutimi të jetë gjithëpërfshirës dhe sa më shumë studentë të marrin pjesë. Annex Nr. 2.5- Rregullore e Programit të Studimit. Annex Nr.2.10- Marrëveshje e Bashkëpunimit në mbështetje të praktikave personale Annex Nr.4.13- Tabela përmbledhëse e aktiviteteve kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare e studentëve të DSHS Link 5.19 https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/ Link 5.20 https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-29-date-7-10-2022-per-frekuentimin-e-procesit-mesimor-sipas-llojit-te-veprimtarive-mesimore-ne-auditor-dhe-ciklit-te-studimit Link5.21 https://www.unkorce.edu.al/bashkepunimi-dhe-koordinimi-sa-me-efektiv-midis-universitetit-fan-s-noli-dhe-institucioneve-me-qellim-zhvillimin-e-praktikave-te-studenteve-dhe-jo-vetem-ishte-qellimi-i-nje-tryeze Link 5.22 https://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-larte-dhe-kerkimin-shkencor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise-dhe-aktet-nenligjore-ne-zbatim-te-tij-2/
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik është i organizuar në vazhdimësi në veprimtari shkencore jashtë programit të studimit dhe për këtë qëllim organizon orë të hapura me guest-lectures por edhe inkurajon studentët që të marrin pjesë në seminarët akademike të organizuara nga universiteti Fan S. Noli apo institucione të tjera duke paraqitur edhe punimet e përgatitura nga studentët në bashkëpunim edhe me pedagogët. Kjo nevojë diktohet edhe nga mobiliteti i studentëve si në dalje ashtu edhe në ardhje pranë

	këtij universiteti. <i>Annex Nr. 5.24- Lista e leksioneve të hapura</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Pedagogët promovojnë pjesmarrjen e studentëve në aktivitetet shkencore ku ata mund të marrin pjesë me prezantime për të inkurajuar më tej idetë e tyre inovative duke i ofruar edhe mundësinë e financimit të pjesmarrjes në këto aktivitete. Pjesmarrja e studentëve në projektet kërkimore është një nga kriteret për përzgjedhjen e këtyre projekteve të financuara nga fondi i universitetit, çka nxit më tej dëshirën e pedagogëve për të angazhuar më tej studentët në kërkim. IAL i akordon një fond vjetor Këshillit Studentor si mbështetje për aktivitetet e parashikuara me qëllim zbatimin e ideve inovatore <i>Annex Nr.1.19- Rregullore e Këshillit të Etikës</i> <i>Annex Nr.4.13- Lista e aktiviteteve bashkëpunuese në kuadër të shkëmbimeve apo mobiliteteve</i> <i>Link 5.19</i> https://arsimi.gov.al/vendim-nr-185-date-25-3-2021-per-disa-ndryshime-dhe-shtesa-ne-vendimin-nr-41-date-24-1-2018-per-elementet-e-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte/ <i>Link 5.20</i> https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-29-date-7-10-2022-per-frekuentimin-e-procesit-mesimor-sipas-llojit-te-veprimtarive-mesimore-ne-auditor-dhe-ciklit-te-studimit <i>Link5.21</i> https://www.unkorce.edu.al/bashkepunimi-dhe-koordinimi-sa-me-efektiv-midis-universitetit-fan-s-noli-dhe-institucioneve-me-qellim-zhvillimin-e-praktikave-te-studenteve-dhe-jo-vetem-ishte-qellimi-i-nje-tryeze <i>Link 5.22</i> https://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-larte-dhe-kerkimin-shkencor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise-dhe-aktet-nenligjore-ne-zbatim-te-tij-2/
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet harmonizimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies me kërkimin shkencor, studimet në terren, por edhe falë mobilitetit të pedagogëve. Pjesmarrja e studentëve në aktivitetet akademike dhe në ato kërkimore synon zhvillimin e thelluar të kompetencave të tyre profesionale dhe shkencore. Pjesmarrja e studentëve në projektet kërkimore është edhe një nga kriteret e përzgjedhjes së këtyre projekteve të financuara nga fondi i universitetit, çka nxit</i>




	<i>më tej dëshirën e pedagogëve për të angazhuar më tej studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Rregullorja e Universitetit përcakton procedurat që duhet të ndjekin studentët lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe projektin e diplomimit. Përsa i takon programit të masterit shkencor, studentët duhet që fillimisht të përmbyllin të gjitha detyrimet për çdo modul të programit dhe më pas mund të fillojnë punimin përfundimtar për diplomimin, informacion i cili është i aksesueshëm online dhe bëhet në konsultim me pedagogun. Punimi përfundimtar konsiston në një tezë të cilën studentët fillojnë ta hartojnë në semestrin përmbyllës të vitit të dytë të programit, ndërsa e gjithë procedura përshkruhet në dokumentin përkatës. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 89-90.</i> <i>Annex Nr. 2.5 - Rregullorja e Programit të Studimit</i> <i>Annex Nr.2.3- Rregullore e Njesisë Bazë</i> <i>Annex Nr. 2.14 - Manuali i Punimit të Diplomës</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Çdo pedagog i caktuar si mbikqyrës i tezës punon me studentin duke e udhëzuar për formimin e argumentit shkencor dhe materialet e që duhet të konsultojë studenti. Pedagogët por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Ky informacion përfshin detyrimet akademike që studentët kanë për përmbylljen e programit. Tema dhe udhëheqësit miratohen nga Departamenti i Shkencave Sociale pas konsultimeve me studentët diplomantë. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 89-90.</i> <i>Annex Nr. 2.5 - Rregullorja e Programit të Studimit</i> <i>Annex Nr.2.3- Rregullore e Njesisë Bazë</i>

	Annex Nr. 2.14 - Manuali i Punimit të Diplomës
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Programi nuk organizon një provim përfundimtar për të testuar njohuritë e studentëve në përfundim të programit por një punim përfundimtar të diplomës. Departamenti ngre një komision të posaçëm me anëtarët e departamentit për administrimin e punimeve të tezës (dizertacionit). Ky komision vlerëson dhe ofron feedback për çdo punim, përpara se të shpallet nga departamenti data e mbrojtjes me gojë të dizertacioneve. Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 89-90. Annex Nr. 2.5 - Rregullorja e Programit të Studimit Annex Nr.2.3- Rregullore e Njesisë Bazë Annex Nr. 2.14 - Manuali i Punimit të Diplomës
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Studentët mund të zgjedhin ndërmjet stafit akademik të programit udhëheqësin për dizertacionin duke patur parasysh përputhshmërinë e fushës së kompetencave akademike të pedagogut me temën e dizertacionit që ata mendojnë. Më pas së bashku me udhëheqësin kristalizohet më tej tema e dizertacionit. Përcaktimi i udhëheqësit dhe temës së dizertacionit i hap rrugën aprovimit nga ana e koordinatorit të Departamentit. Studenti punon në temën e dizertacionit duke u konsultuar dhe orientuar në çdo hap nga udhëheqësi duke filluar nga gërshetimi i metodologjisë së dizertacionit me kerkimin shkencor, rezultatet, përpunimin e tyre dhe hartimin e konkluzioneve. Studenti paraqet drafte të punës dhe merr vazhdimisht feedback nga udhëheqësi, i cili duhet të japë aprovimin në mënyrë që studentin të mund të dorëzojë tezën. Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 89-90. Annex Nr. 2.5 - Rregullorja e Programit të Studimit Annex Nr.2.3- Rregullore e Njesisë Bazë Annex Nr. 2.14 - Manuali i Punimit të Diplomës
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Udhëheqësit i asistojnë studentët në të gjitha hapat e përgatitjes dhe punimit të dizertacionit., përveç vendosjes në dispozicion të studentit të të gjithë bazës së nevojshme materiale brenda institucionit për hartimin e dizertacionit, por edhe jashtë tij. Për këtë, udhëheqësi ofron gjithashtu nëpërmjet kontakteve personale edhe mundësinë që studentin të marrë ekspertizën dhe ndihmën e nevojshme me ekspertë jashtë institucionit kur kjo është e nevojshme

	<i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 89-90.</i> <i>Annex Nr. 2.5 - Rregullorja e Programit të Studimit</i> <i>Annex Nr.2.3- Rregullore e Njesisë Bazë</i> <i>Annex Nr. 2.14 - Manuali i Punimit të Diplomës</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Dizertacioni vlerësohet nga komisioni prej tre anëtarësh i ngritur dhe aprovuar për këtë qëllim sipas rregullores së departamentit me një sistem notash nga 4-10 – dhe bërë kalimin nga sistemi i pikëve tek ai i notave - duke patur parasysh cilësinë shkencore të punimit, si edhe duke i ofruar studentit feedback lidhur me aspektet pozitive ashtu dhe pikat që meritonin më shumë vëmendje. Komisioni jep feedback mbi vlerësimin e bërë me shkrim. Si minimum i notës kaluese konsiderohet pragu i notës 5. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 63/64, kreu VII neni 89-90.</i> <i>Annex Nr. 2.5 - Rregullorja e Programit të Studimit</i> <i>Annex Nr.2.3- Rregullore e Njesisë Bazë</i> <i>Annex Nr. 2.14 - Manuali i Punimit të Diplomës</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	IAL në rregulloren e institucionit ofron udhëzime të qarta për pajisjen e studentit me diplomën “Master i Shkencave në Etika dhe Liderशिpi”. Në përfundimin e suksesshëm të programit të gjithë studentët pajisen me diplomën e Masterit Shkencor dhe me suplementin e diplomës. Forma dhe përmbajtja e këtyre dokumentave janë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Qendra Kombëtare e Shërbimit të Studentëve (QSHA), dhe rregjistrohen pranë Zyrës së Rregjistrimit, ndërsa dorëzimi i tyre bëhet në një ceremoni të veçantë. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu IV, neni 63/64, kreu VII neni 89-90.</i> <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VI, neni 70/71, kreu VII neni 89-90.</i> <i>Annex Nr. 2.2 - Rregullorja e Njesisë Kryesore Kreu III, neni 50</i> <i>Annex Nr.2.3- Rregullore e Njesisë Bazë</i> <i>Annex Nr. 2.14 - Manuali i Punimit të Diplomës</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione	Sekretaria Mësimore ka si detyrë mbajtjen e regjistrit themeltar me të dhënat e studentëve, si në formën fizike ashtu edhe në atë elektronike. Kjo Sekretari ngarkohet edhe me mbajtjen e kartelës së studentit ku pasqyrohen kreditet e akumuluar dhe aktiviteti akademik. Rregjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave që vërteton emërtimin e certifikatave dhe diplomave. Dosjet

për studentin nëse kërkohen.	personale të studentëve pas diplomimit ruhen në arkivin qendror të universitetit duke respektuar normat në fuqi për privatësinë por edhe rregulloren e këtij arkivi. Annex Nr. 1.10- Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit TIK			
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin nga udhëheqësi i tezës finale. IAL Fan Noli e përgatit studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë si diplomën ashtu edhe diploma suplement.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet

Kriteri 3. Praktik profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky kriter nuk aplikohet			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin	Institucioni ndjek procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike në bazë të nevojave të njësive bazë. GVJ bazuar në shqyrtimin e dosjeve të personelit dhe bisedës me ta vlerëson se personeli akademik efektiv dhe me kontratë që angazhohet në realizimin e programit të studimit master i shkencave “Etika dhe Liderhipi” i ofruar nga Departamenti i Shkencave Sociale, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka një eksperiencë disavjeçare në mësimdhënie dhe në fushën e kërkimit

në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	shkencor siç vërtetohet edhe nga botimet dhe pjesëmarrja në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare Stafi i angazhuar për programin e studimit në tituj dhe grada për PAE/PAK është si më poshtë vijon: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/grada</th><th colspan="2">2022 - 2023</th><th colspan="2">2023 - 2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td><u>1</u></td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td><u>3</u></td><td>2</td><td>3</td><td>2</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td><u>9</u></td><td>-</td><td>9</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td><u>1</u></td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Në total</td><td>14</td><td>2</td><td>14</td><td>2</td></tr></table> Annex Nr. 4.1 Tabela e personelit akademik në prog e stud Annex Nr. 2.9 Jetëshkrimet e stafit	Tituj/grada	2022 - 2023		2023 - 2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	<u>1</u>	-	1	-	Prof.As.Dr	<u>3</u>	2	3	2	Dr/PhD	<u>9</u>	-	9	-	Msc	<u>1</u>	-	1	-	Në total	14	2	14	2
Tituj/grada	2022 - 2023		2023 - 2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr	<u>1</u>	-	1	-																															
Prof.As.Dr	<u>3</u>	2	3	2																															
Dr/PhD	<u>9</u>	-	9	-																															
Msc	<u>1</u>	-	1	-																															
Në total	14	2	14	2																															
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Vlerësimi i stafit bazohet në shqyrtimin e dosjeve të personelit në zyrën e Burimeve Njerëzore. Stafi akademik efektiv mbulon nga 3-4 lëndë mësimore në departament. Fusha akademike e tyre është në përputhje me modulet dhe lëndët ku ata janë aktivizuar. Rreth 79.3 % e ngarkesës mësimore për programin e studimit mbulohet nga stafi akademik me kohë të plotë dhe 20.7 nga stafi akademik me kohë të pjesshme, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Annex Nr. 4.2 Tabela e ngarkesës së stafit akademik në të gjitha programet Annex Nr. 4.1 Tabela e personelit akademik në prog e stud Annex Nr. 2.9 Jetëshkrimet e stafit																																		
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ në takimin me burimet njerëzore dhe bisedën me stafin akademik efektiv dhe me kontratë në UNIKO konstatoi se personeli akademik i angazhuar në realizimin e këtij program studimi kanë një angazhim përmbajtësor në lëndët përkatëse, dhe drejtuesi i departamentit ka përvojë të gjatë drejtuese në krye të njësisë. Stafi është në zhvillim të mëtejshëm të karrierës akademike në kërkim të titujve dhe gradave gjë që tregon për qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit. GVJ verifikoi kontratat mbi marrëdhëniet e punësimit në UNIKO. Nëpërmjet kontratës së punësimit personeli akademik i angazhuar mbulohet me sigurime shoqërore dhe shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi. Annex Nr. 1.14 Udhezimi për përmbajtjen e dosjes së stafit																																		




Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Takimi i GVJ me stafin akademik konfirmoi se ata janë titullarë të moduleve, lëndëve në përputhje me nivelin e kualifikimit të tyre dhe përmbajtjen e programit të studimit, dhe të rekrutuar sipas rregulloreve të UNIKO dhe Statutit. Mbi bazën e kritereve të përcaktuara nga institucioni, shpallet konkurs i hapur për vendet e lira të punës për personel akademik dhe kryhet publikimi në faqen online të UNIKO, rrjete sociale zyrtare të institucionit dhe në portale të tjera të punësimit. Nga takimi i GVJ me drejtorinë e burimeve njerëzore në universitet na u vunë në dispozicion CV-akademike dhe kontratat e punës, si dhe procedurat standarde të rekrutimi dhe vlerësimit të stafit akademik. GVJ gjykon se UNIKO mbështetet në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit, procedurë transparente të rekrutimit të stafit akademik efektiv dhe jo efektiv në përputhje me aktet ligjore. <i>Annex Nr. 1.13 Udhezim për rekrutimin e stafit akademik</i> <i>Annex Nr. 1.1 Statuti i UK</i> <i>Annex Nr. 1.2 Rregullorja e UNIKO</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në UNIKO konstatoi se personeli ndihmës akademik i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi ka nivelin e duhur të kualifikimit sipas përcaktimeve të Rregullores së programit të studimit dhe përmbushin me korrektësi dhe etikë detyrimet e tyre. Për natyrën e programit të studimit master i shkencave në “Etika dhe Liderशिpi”, për realizimin e tij nuk ka nevojë për orë laboratorike apo për mjedise të tjera specifike mësimore. Laboratorët, sallat e leksionit dhe mjediset e tjera të mësimdhënies janë të pajisura me infrastrukturë moderne dhe pajisje teknologjike të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe objektivave formues të programit të studimit. Institucioni ka laboratorë kompjuterikë me kapacitet 86 vendësh (60 kompjutera në dy salla) si dhe në bibliotekën e fakultetit (26 kompjutera). <i>Annex Nr. 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë të njësive bazë</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë	GVJ gjatë vizitës në UNIKO e takimit me drejtorinë juridike dhe burimeve njerëzore konstatoi se statistikën mbledhen dhe përpunohen periodikisht çdo vit akademik. DJBNJ përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit dhe i ruan në dosjet individuale të të gjithë personelit. Institucioni i raporton në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në formë elektronike dhe në letër këto të dhëna që përfshijnë



anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	statistikat mbi personelin akademik efektiv dhe jo-efektiv, ndihmës-akademik me kohë të plotë e të pjesshme, personelin akademik sipas titujve dhe gradave, statistika mbi ngarkesën mësimore të personelit akademik, etj. <i>Annex Nr. 1.1 Statuti i UK</i> <i>Annex Nr. 1.2 Rregullorja e UNIKO</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UNIKO, FSHNSHH dhe DSHS kanë marrëveshje me IAL dhe organizata publike dhe kompani biznesi dhe nënshkruajnë në mënyrë të vazhdueshme marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, biznese dhe organizata të shoqërisë civile për praktikën profesionale të studentëve. <i>Annex Nr. 3.5 Tabela e institucioneve bashkëpunuese të praktikave</i> <i>Annex Nr. 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Aktet rregullative përcaktojnë procesin e zhvillimit të praktikës mësimore për studentët e programit master, ku personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve. Për këtë program studimi praktika realizohet në mënyrë intensive për 5 javë ku studenti duhet të jetë çdo ditë në institucionin e përcaktuar për 5 orë në ditë. Një rëndësi e veçantë i kushtohet aftësimit të studentëve për të realizuar, jo vetëm aplikimin e njohurive praktike, por edhe zhvillimin e mendimit kritik si dhe të aftësive kërkimore të tyre. Komunikimi efektiv ndërmjet studentëve dhe stafit mbikqyrës është thelbësor. Stafi mbikqyrës merr pjesë aktive në procesin e vlerësimit të praktikës së studentit. Vlerësimi përfshin performancën e studentit gjatë praktikës, ofrimin e komenteve




	dhe kontributin në vlerësimin përfundimtar të këtij procesi. Annex Nr. 2.5 Rregullore e programit të studimit 2023-2024 Annex Nr. 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave			
Konkluzione	GVJ konfirmon se personeli akademik që mbulon programin e studimit përmbush plotësisht standardet e cilësisë dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e një mësimdhënie bashkëkohore dhe të kërkimit shkencor sipas fushave të programit të studimit. Personeli akademik mbështetet nga stafi ndihmës dhe mjedise bashkëkohore që garantojnë mësimdhënie që përmbush standardet e cilësisë. Marrëveshjet e bashkëpunimit të UNIKO sigurojnë personelin mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në përputhje me fushën e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ vizitoi mjediset e UNIKO dhe vlerëson se ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit në auditore në përputhje me numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studii. Institucioni plotëson normativën e sipërfaqes (2.27 m ² për student) dhe vëllimit të shfrytëzueshëm për student, plotëson normativat e ndriçimit natyral, siguron ngrohje dhe ftohje në të gjithë godinën dhe përmbush kërkesat për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit. Annex Nr.1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO Annex Nr.4.7 tabela e të dhënave për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa,	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe bisedës me stafin vlerëson se mjediset mësimore si sallat e leksioneve dhe seminareve,

laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	laboratoret, bibliotekat dhe mjediset e tjera plotësojnë të gjitha kushtet për mësimdhënie dhe pune në funksion të programit të studimit. Auditoret janë të pajisura me videoprojektor dhe me mjetet e nevojshme të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Ato lehtësojnë aplikimin e metodave interaktive në auditor, ndërveprimin me studentët duke lehtësuar zbatimin e programit. Vizita në institucion RVB
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ konfirmon sikurse edhe më sipër se DSHS disponon një laborator të pajisur me mjete të teknologjisë për plotësimin e kërkesave të lëndëve, apo moduleve të programit të studimit, si dhe hulumtimit individual të studentëve. UNIKO siguron së paku laboratorë të teknologjisë së informacionit, ku përveç aktivitetit mësimor, për të aplikuar njohuritë e tyre përkatëse, departamenti organizon aktivitete ekstra-kurrikulare si leksione të hapura, workshope, seminare ku prezantohen punime të realizuara nga studentët në projektet e kurseve duke përmbushur objektivat formues të programit të studimit në tërësi.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Ky program studimi nuk ka nevojë për laboratorë/ atelie specifike.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me	UNIKO në nivel universiteti, njësie kryesore dhe njësie bazë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme (si psh: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, Bashkia Maliq, Bashkia Devoll, Prefektura e Qarkut Korçë, Biblioteka




institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	“Thimi Mitko” etj). Praktika profesionale organizohet pranë institucioneve publike dhe private me të cilat UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi, përmes të cilave mundësohet zhvillimi i tyre dhe përmbushja e detyrimeve të programit për këtë komponent. Përmes praktikës profesionale synohet aplikimi i teorisë në praktikë dhe afrimi i studentit me tregun e punës. Për përmbushjen e objektivave të procesit mësimor dhe formimit profesional, institucioni mundëson zhvillimin e praktikës në përshtatje me natyrën dhe profilin e studimit. Annex Nr 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave Annex Nr 3.5 Tabela e institucioneve bashkëpunuese të praktikave https://unkorce.edu.al/bashkepunime/			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se UNIKO disponon një infrastrukturë me mjedise mësimore dhe pajisjet e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit. Për formimin praktik të studentëve sipas natyrës dhe fushës së këtij programi masteri janë nënshkruar një sërë marrëveshjes me institucione publike, biznese dhe OJF e shoqata.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit	Nga takimi me studentët dhe vizita në mjediset e bibliotekës së UNIKO, u konstatua se studentëve ju vihet në dispozicion literatura bazë fizike, materiale të shkruara si dhe marrja me shkrim, për realizimin e programit të studimit. Kjo literaturë është përgatitur nga personeli i angazhuar sipas lëndëve dhe moduleve. Studentët

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al




(fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	kanë një fond të madh të librave të lëndëve apo moduleve në shqip në bibliotekën e UNIKO. Krahas kësaj, garantohet dhe literaturë ndihmëse. Në programet mësimore të çdo lënde apo moduli përcaktohet literatura bazë dhe literatura ndihmëse që mund të shfrytëzojnë studentët. Literatura bazë përbëhet nga tekstet mësimore, dispensat, praktikumet, që mund të gjenden në bibliotekë. Literatura ndihmëse mund të gjendet në bibliotekën e fakultetit ose në bibliotekën e Uniko. <i>Annex Nr. 4.10 Te dhena per fondin e librave ne biblioteke</i> <i>Annex Nr.4.7. Tabela e të dhënave infrastrukturore në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	FSHNSHH si pjesë e UNIKO, ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë me disa mjedise dhe hapësira të mjaftueshme, ku studentët gjejnë kushte sa më optimale për shfrytëzimin e saj. Fondi është aktualisht i shpërndarë në pesë mjedise dhe përkatësisht në: Biblioteka Shkencore Universitare (Rektorat), Bibliotekën e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, Bibliotekën e Fakultetit Ekonomik, Bibliotekën e Fakultetit të Bujqësisë, Bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane. Në Bibliotekën online gjendet një literaturë bashkëkohore, e cila mbulon fushat parësore të kërkimit në Universitet, si në fushën e edukimit, bujqësisë, ekonomisë, shkencat filologjike, shkencat sociale, natyrore, mjekësore, etj <i>Annex Nr. 4.10 Te dhena per fondin e librave ne biblioteke</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në DVV, pohojmë se biblioteka e UNIKO ka në fondin e saj dhe vë në dispozicion të studentëve disa prej teksteve mësimore dhe literaturë të rekomanduar në gjuhë shqipe apo të huaj, programin e studimit që ofron DSHS. Modulet dhe veprimtaria mësimore e programit mbulohet nga një numër i vogël tekstesh dhe disa revistash shkencore, të cilat mbulojnë thuajse të gjitha modulet dhe veprimtaritë e programit mësimor. Fondi total i librave të bibliotekës është 15080, fondi i titujve të librave të bibliotekës është 1665, Janë blerë 79 tituj librash. <i>Annex Nr. 4.10 Te dhena per fondin e librave ne biblioteke</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista	Për të gjithë studentët dhe stafin akademik të UNIKO, përdorimi i bibliotekës mundësohet pa pagesë. Institucioni ka krijuar mundësi për akses të barabartë për studentët, personelin akademik dhe të interesuarit në funksion të procesit mësimor, formimit profesional dhe veprimtarisë shkencore të institucionit. Që nga viti 2018 ofrohet një mundësi e re qasjeje në bibliotekën online Jstore-mundësuar




shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	nga AADF, Ebsco-mundësuar nga RASH. <i>Annex Nr. 4.10</i> Te dhena per fondin e librave ne biblioteke, <i>Annex Nr. 1.6</i> Marreveshja me RASH per sist elektronik PITAGORA). https://al.cobiss.net/
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Referuar RVB, biblioteka e Universitetit / FSHNSHH janë të pajisura me programe kompjuterike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët e “Programit të studimit master i shkencave” në “Etika dhe Lidershipi”. Biblioteka është e pajisur me pajisje teknologjike që mundësojnë dhe shpejtojnë kërkimin e shpejtë të literaturës fizike e digjitale. <i>Annex Nr. 4.10</i> Te dhena per fondin e librave ne biblioteke, <i>Annex Nr. 1.6</i> Marreveshja me RASH per sist elektronik PITAGORA). https://al.cobiss.net/
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga biseda me studentët, rezultoi që edhe ata e preferonin literaturën online në formatin elektronik, si artikuj e libra sipas lëndëve dhe orientimit të pedagogëve. Biblioteka e ndodhur në katin zero që GJV vizitoi kishte vende qëndrimi mjaftueshëm për numrin e studentëve të këtij programi masteri, dhe po ashtu laboratorët me kompjutera në katet e mësipërme mund t’i përdornin studentët për aksesimin e Bibliotekës online si Cobiss.al.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Për të mundësuar shfrytëzimin e barabartë të mjediseve të bibliotekës, biblioteka qëndronte e hapur deri në orën 16. Ky orar është një orar i përshtatshëm, për studentët. Biblioteka në bazë të kapacitetit të saj, përmbush nevojat e studentëve, dhe numrin e studentëve që e shfrytëzojnë atë, brenda orarit të shërbimit të saj. Rreth 855 studentë dhe 45 pedagogë kanë kartelat e tyre personale në këto biblioteka. <i>Annex Nr. 4.10 Te dhena per fondin e librave ne biblioteke</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës	Personeli akademik, informon bibliotekën për tituj të rinj, duke realizuar pasurimin e fondit të bibliotekës në mënyrë të vazhdueshme. Njësia bazë që ndjek programin e studimit njofton dhe bibliotekën për të ndjekur pasurimin e fondit të saj të librit. Si pjesë e analizave vjetore institucionale, janë të dhënat mbi cilësinë

dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik, të bibliotekës së UNIKO. Biblioteka garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e çdo programi studimi e pa pagesë. Një pjesë e teksteve mësimorë dhe dispensave që kanë lidhje me lëndët e modulet e që zhvillohen në programin e studimit profesional MSH në: “Etika dhe Lidershipi”, gjenden si në Bibliotekën e UNIKO ashtu edhe në bibliotekën e FSHNSHH. <i>Annex Nr. 4.10 Te dhena per fondin e librave ne biblioteke</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave Sociale, ka një literaturë të kënaqëshme tek studentët për të realizuar programin e studimit, por pasurimi i mëtejshëm me literaturën më të fundit fizike dhe të përditësuar është i nevojshëm në bibliotekën e tij në mbështetje të mësimdhënies. Mundësitë me literaturat online janë të pëlqyeshme, si për stafet akademike edhe për studentët e Masterit Shkencor. Aksesit në to është i njëjtë për të gjithë në mjediset e brendshme të UNIKO.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë	Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të një sërë dokumentesh, GVJ vlerëson se strukturat akademike dhe ndihmës akademike në UNIKO, nga sekretaritë deri tek njësia bazë sigurojnë administrimin e gjithë informacionit në lidhje me studentët, nga

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	regjistrimi për studentët e rinj, informimi në mënyrë të vazhdueshme për oraret, lëndët, provimet, mundësitë që ata kanë për trajnime, mobilitete apo praktika profesionale gjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre, deri në diplomim. UNIKO përdor sistemin Pitagora për menaxhimin, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Sekretaria mësimore është gjithashtu pjesë e këtij sistemi menaxhimi, Ato disponojnë të gjithë dokumentacionin fizik për këtë qëllim. UNIKO ka marrëveshje me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH) me anë të së cilës realizon menaxhimin e karrierës së studentëve si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave. GVJ shqyrtoi nëpër regjistrat standard një bazë të dhënash të plota e të përditësuara mbi studentët të tilla si: gjeneralitetet, programi i studimit që ndjekin, data/viti i regjistrimit për programin e studimit, shkolla e mesme nga kanë ardhur, notat e fituara përgjatë ciklit të studimeve, kontaktet, datë çrregjistrimi dhe transferimi (për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera), dhe datën e diplomimit. <i>Annex Nr. 1.6. Manual i sistemit elektronik Pitagora</i> <i>Annex Nr. 1.6.1. Marrëveshja me rash për sistemin elektronik Pitagora</i> <i>Annex Nr.1.10 Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të tik</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga vizita në Drejtorinë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore, u konstatua që kjo drejtori administron sistemin e brendshëm të menaxhimit, administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Gjithashtu, disponon të gjithë dosjet e personelit akademik, me kohë të plotë, të pjesëshme apo të ftuar, si dhe personelit ndihmës akademik, ku gjenden të gjitha informacionet dhe dokumentet përkatëse. GVJ pa dhe dokumentacionin e personelit të DSHS, FSHNSHH. Dosjet i nënshtrohen përditësimeve me dokumenta të tjera në mënyrë të vazhdueshme. <i>Annex Nr. 1.4 Rregullorja e drejtorise juridike dhe burimeve njerezore</i> <i>Annex Nr. 1.14 Udhezimi per permbajtjen e dosjes se stafit</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses	Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të



të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	studimit. Pjesa e dedikuar për studentët ju mundëson atyre informimin dhe komunikimin mbi aktivitetet mësimore, rregulloret, udhëzimet dhe të dhëna të tjera për programin, i gjithë ky sistem është i aksesueshëm edhe nga jashtë institucionit si nga personeli akademik ashtu edhe nga studentët. Ky menaxhim informacioni dhe dokumentacioni realizohet nga Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore. Informacionet për personelin apo studentët e programit të studimit, bëhen duke ruajtur të dhënat zyrtare sipas akteve ligjore në fuqi. Mbrojtja e të dhënave personale për gjithë sistemet e informacionit më lart respektohen nga dispozitat e ligjit 9887. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit të UNIKO. Annex Nr. 1.4 Rregullorja e drejtorise juridike dhe burimeve njerezore Annex Nr. 1.9 Rregullore per mbrojtjen, ruajtjen dhe perpunimin e te dhenave personale
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Marrëveshja midis RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar) dhe Uniko parashikon ofrimin e shërbimeve informatike dhe shkëmbimit të informacionit. Të gjitha shërbimet Software që ofron RASH për Uniko, grupohen në një sistem të posaçëm menaxhimi i specializuar për Uniko. Annex Nr 1.6. Marrëveshja me rash për sistemin elektronik Pitagora Annex Nr 1.6.1 Manual i sistemit elektronik PITAGORA http://www.unkorce.edu.al/sq/lms
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi Pitagora i përdorur në programin e studimit master i shkencave në “Etika dhe Liderhipi”, mundëson aksesimin në kohë reale të informacionit në lidhje me studentët, pedagogët, universitetin, lëndët, oraret e mësimi, notat dhe informacione të tjera të universitetit. Për secilin përdorues ka një udhëzues të veçantë për përdorimin e modulit përkatës. Sistemi Pitagora siguron akses për çdo student e pedagog dhe është i mbrojtur nga ndërhyrjet e jashtme. Thëksojmë se <i>sistemi nuk mundëson monitorimin apo raportimet individuale në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ.</i> Annex Nr. 1.6. Marrëveshja me rash për sistemin elektronik Pitagora Annex Nr 1.6.1 Manual i sistemit elektronik PITAGORA http://www.unkorce.edu.al/sq/lms




Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UNIKO publikon në faqen zyrtare informacione që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme. GJVJ pa se në faqen elektronike zyrtare të universitetit ka informacion për lëndët e programit të studimit, personelin akademik të angazhuar, informacion për aktivitete shkencore si simpoziume apo konferenca etj. Gjithashtu informacioni është dhe për programin e studimit master i shkencave në "Etika dhe Liderhipi" si dhe për personelin akademik të përfshirë në mësimdhënie, aktivitetet e ndryshme që zhvillohen në nivel departamenti. http://www.unkorce.edu.al			
Konkluzione	<i>GJVJ gjatë vizitës në UNIKO konstatoi se Sistemi i Menaxhimit garanton informacionet mbi aktivitetet akademike e administrative në kohë reale, të cilat mundësojnë monitorimin dhe raportime individuale. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Faqja online e UNIKO përmban të gjitha informacionet mbi personalin akademik, programet e studimit, aktivitete.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit	Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Drejtoria Financiare dhe Drejtoria Ekonomike garantojnë financimin dhe mbështetjen e procesit mësimor kërkimor. UNIKO harton dhe raportin financiar vjetor për mbarëvajtjen e programit master i shkencave në "Etika dhe Liderhipi", për ciklin e plotë të studimit, në kuadër të raportit vjetor. Në raportin financiar parashikohen shpenzimet e



për të paktën një cikël të plotë studimi.	nevojshme për mirëmbajtjen e mjediseve dhe elementëve të nevojshme për mbarrëvajtjen programit mësimor të këtij cikli studimi. <i>Annex Nr. 1.8. Rregullore e drejtorisë financiare (EDE)</i> <i>Annex Nr. 1.7. Rregullore e drejtorisë ekonomike,</i> <i>Annex Nr. 1.8.1. Rregullorja financiare</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Nga evidencat e shqyrtuara gjatë vizitës në institucion dhe ato në faqen online të UNIKO, GVJ konfirmon se Plani financiar mban të gjitha elementet dhe zërat specifik për financimin e tij, si: orët mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, kualifikimeve afatshkurtra dhe afatmesme, brenda dhe jashtë vendit, projektet, aktivitete shkencore e shpenzimet e ndryshme operative, etj. UNIKO, në baze të propozimit të fakulteteve (FSHNSHH merr propozimet nga DSHS) harton çdo vit planin e financimit ose projekt buxhetin, i cili miratohet nga senati dhe bordi i administrimit, në të cilin pasqyrohen të gjitha financimet e nevojshme për njesinë bazë, me qëllim realizimin e programit të studimit. Aty përfshihen dhe kostot për organizimin e konferencave kombëtare apo ndërkombetare, që u krijojnë hapësira dhe mundësi për ngritje profesionale personelit akademik apo dhe studentëve, duke qenë pjesë e planit të financimit. Gjithashtu parashikohet edhe një fond për pasurimin e bibliotekës, etj. Burimet financiare të institucionit janë: Buxheti i shtetit; të ardhurat nga tarifat, të ardhura nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe të ardhura nga shërbimet apo të ardhura nga burime të tjera të evidentueshme sipas rregullave në fuqi. <i>Annex Nr. 1.8. Rregullore e drejtorisë financiare (EDE)</i> <i>Annex Nr. 1.7. Rregullore e drejtorisë ekonomike,</i> <i>Annex Nr. 1.8.1. Rregullorja financiare</i> <i>Annex Nr.3.15 Raporti financiar për kostot e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UNIKO kryen auditim financiar periodik, që realizohet nga audit i brendshëm, për të vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. UNIKO i nënshtrohet auditimit nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit për të gjitha zërat e financimeve duke u bazuar në dokumentacionin që disponon institucioni. Në raport, pasqyrohen gjetjet dhe jepen konkluzione rreth veprimtarisë së institucionit.




	Annex Nr. 1.7. Rregullore e drejtorisë ekonomike, Annex Nr. 1.2 Rregullorja e UNIKO			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në nivel institucional, strukturat përgjegjëse përgatisin analiza vjetore ku jepen dhe pasqyrat që tregojnë nivelin e realizimit të buxhetit të vitit paraardhës për çdo njësi bazë. Në analizën vjetore pasqyrohen niveli i realizimit ose mosrealizimit të buxhetit të miratuar duke treguar dhe shkaqet për rastin e mosrealizimit. Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se institucioni nuk ka buxhet të vecantë për programet, pra as për programin e studimit master i shkencave në “Etika dhe Liderशिpi”. Annex Nr. 1.7. Rregullore e drejtorisë ekonomike, Annex Nr. 1.2 Rregullorja e UNIKO Web-I I UNIKO: Programi i transparencës			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	UNIKO garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, duke marrë në konsideratë kërkesat e njësisë bazë, më tej të njësisë kryesore, për një buxhet të mjaftueshëm. Raporti i veprimtarisë financiare, diskutohet me organet kolegjiale të Universitetit, si në Rektorat, Bordin e Administrimit dhe në Senatin Akademik. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme të financimit të programeve të studimeve Annex Nr. 1.11. Rregullore e Senatit Akademik Annex Nr. 1.7. Rregullore e drejtorisë ekonomike, Annex Nr. 3.15 Raporti financiar për kostot e programit të studimit. Annex Nr. 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të UNIKO Web-i i UNIKO: Programi i transparencës			
Konkluzione	<i>GVJ referuar dokumenteve kryesore si statuti e rregullore të UNIKO dhe pas vizitës në institucion konfirmon se institucioni rregullisht përpilon raportin financiar për kostot e programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të tij. UNIKO garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Për mbulimin e ciklit të plotë akademik të studentëve universiteti Fan Noli i përmbahet dispozitave ligjore në fuqi siç janë Ligji i Arsimit të Lartë udhëzimi “Për Miratimin e Kalendarit për Procedurat e Aplikimit dhe Rregjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë për Vitin Akademik Pasardhës”, por edhe rregulloreve të brendshme të hartuara nga institucioni siç janë Statuti dhe “Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane”, si edhe rregullores së programit, të cilat rregullojnë në mënyrë më të detajuar këto procedura. Rregulloret e mësipërme përcaktojnë politikat dhe procedurat në lidhje me kuotat e studentëve për çdo vit akademik në bazë të kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore të institucionit. Bazuar në aplikimet e marra përmes portalit U-Albania, Fan Noli përgatit listën e studentëve fitues dhe pas publikimit në portalin e U-Albania ato publikohen edhe në faqen web të institucionit. Rregjistrimi i studentëve vendas dhe të huaj bëhet mbështetur në udhëzimin nr. 10 “Procedurat e aplikimit dhe rregjistrimit në IAL” dhe bazuar në “Kuotat e Pranimi”. Pas rregjistrimit të gjithë studentët pajisen me numër matrikullimi nga QSHA dhe me kartën e studentit. Ndërkohë për të ofruar një perspektivë të plotë të aktivitetit akademik, institucioni organizon ditë të hapura me studentët. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, nenet</i>

	47, 48. <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", nenet 56, 57.</i> <i>Annex Nr. 2.2 - Rregullorja e Njesisë Kryesore, neni 47</i> <i>Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit, pika 8 dhe 15</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Siç u shpjegua IAL i referohet akteve ligjore kombëtare dhe atyre institucionale duke ndjekur këto hapa: 1) Aplikimet për të gjitha kategoritë e studentëve bëhen pranë Zyrës së Pranimi; 2) Zyra e Pranimi i dërgon dosjet e aplikimit pranë departamentit përkatës ku vlerësohen nga një komision shkencor ad-hoc, i cili operon në nivelin e njesisë bazë; 3) Fan Noli shpall listën e fituesve për cdo program studimi; 4) Kandidatët kryejnë regjistrimin dhe kompletojnë procesin e regjistrimit. Statuti dhe Rregullorja e insitucionit përmbajnë në mënyrë të detajuar të gjitha proceset nga regjistrimi, deri tek perfundimi i studimeve apo transferimet në programe të tjera studimi duke ofruar trasnparencë në proces dhe barazi në trajtimin e studentëve. Të gjitha ambientet dhe godinat e institucionit jane pajisur me ashensorë ose me rampa për të mundësuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara (<i>Vizita në institucion</i>). <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", nenet 93, 94.</i> <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Kreu VI, neni 75</i> <i>Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit, pika 3 dhe 13</i> <i>Annex Nr. 3.26 -Vendimi i Departamenteve për ngritjen e komisionit ad hoc per pranimin dhe ekuivalentimin e krediteve.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Senati Akademik miraton dhe publikon ne faqen zyrtare të IAL kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve, përpara fillimit të çdo viti akademik, në përputhje me Statuin e universitetit. Institucioni harton dhe zbaton në regjistrimin e studentëve në respekt të legjislacionit në fuqi siç janë Ligji 80/2015 miratuar nga MAS dhe Këshilli i Ministrave si edhe kuadrin ligjor institucional siç është vendimi i Senatit nr. 89 datë 27/01/2023. Universiteti shikon çdo vit listat e aplikantëve për secilin program dhe kryen renditjen e fituesve, në përputhje me kuotat e miratuara nga Ministria dhe i gjithë informacioni i referuar pranimi dhe transferimit publikohet ne faqen kryesore të IAL dhe në rrjetet sociale (https://unkorce.edu.al3/qendra-e-karrieres-dhe-alumni-3/). <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", neni 48.</i> <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", 57</i> <i>Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit, pika 8</i>



Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Senati Akademik referuar urdhërit të Ministrisë së Arsimit ka vendosur kuotat e pranimit të programeve të ciklit të dytë për çdo vit akademik. Pranimi në programet e studimit të Ciklit të Dytë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve dhe plotëson kriteret e pranimit në universitet në përputhje me nenin 76 të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë”, si edhe rregulloren e institucionit. Në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.10 datë 15/05/2019, çdo kandidat duhet të sjellë pranë sekretarisë mësimore dokumentat e mëposhtëm: a) formularin e aplikimit; b) letër motivimi; c) kopje të noterizuara të diplomës dhe listës së notave në bachelor; d) CV; e) një kopje të ID ose pasaportës; f) 4 fotografi pasaporte. Kriteret e pranimit janë publikuar në faqen zyrtare të universitetit, si edhe i prezantohen studentëve gjatë takimit në fillim të programit https://unkorce.edu.al/maturantet-pyesin/. Pranimi i transferimit të studentëve bëhet sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa e studentëve për transferimin e krediteve vlerësohet nga një komision ad-hoc i ngritur në nivel departamenti dhe aprovohet nga dekani i fakultetit përkatës. Ky vendim bazohet në listën e notave dhe përshkrimin e secilës lëndë (syllabuse) të marra në universitetin ku ka ndjekur studimet. Sipas rregullores së IAL, komisionet nuk mund të njohin më shumë se 40 kredite transferimi për ciklin e dytë të studimeve në përputhje me Urdhërin e Këshillit të Ministrave n.41 datë 24/01/2018, pika 2.1. Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, nenet 57, 60, 64, 72 dhe 90. Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, nenet 56, 57 dhe nenet 68, 70 Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit, pika 13 Annex Nr. 2.2 -Rregullore e Njësisë Kryesore nenet 37, 38, 42, 50.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Fan Noli informon lidhur me programet zyrtare përmes faqes web (https://unkorce.edu.al/) ku i ofrohet informacion jo vetëm publikut por edhe studentëve të IAL, dhe stafit, lidhur me programet e studimit, karakteristikat e tyre, kurrikulat, si edhe aktivitetet studentore, kulturore dhe shkencore të organizuara nga institucioni. Një sërë aktivitetesh marketingu si reklama, orë të hapura, takime promovuese, të organizuara nga Fan Noli apo publikime si broshuara, students-book, etj synojnë tërheqjen e sa më shumë studentëve. Për të tërhequr më shumë maturantë, FAN NOLI




	organizon orë të hapura, takime maturantët dhe merr pjesë në panairë tematike Universiteti organizon edhe provimin e bursës për t'u dhënë studentëve ekselentë mundësi për të përfituar 100% bursë gjatë periudhës së studimeve (https://unkorce.edu.al/kriteret-e-pranimit/).
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni publikon në fillim të çdo viti kuotat në dispozicion të studentëve që vijnë nga disa kategori të veçanta sociale, në zbatim të kriterëve që janë vendosur nga Ministria e Arsimit në udhëzimin nr. 17, datë 30/07/2019. Universiteti Fan Noli mbështetet në rregulloren e programit të studimit ku përcaktohen kriteret shtesë të pranimit për kuotat e dedikuara studentëve të kategorive të veçanta. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", neni 48.</i> <i>Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit, pika 8.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kuotat e pranimit për studentët me shtetësi të huaj publikohen përpara çdo viti akademik dhe kriteret që ndiqen janë ato të publikuara nga Ministria e Arsimit për këtë qëllim. Kandidatët me shtetësi të huaj duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pranimin në programet e ciklit të parë dhe të dytë. <i>Annex Nr. 2.13- Të dhënat mbi kriteret e pranimit të programit të studimit, tarifat dhe modalitetet financiare për studentët.</i> <i>Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit, pika 8.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Universiteti pas vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar pranë institucionit ofron mbështetje financiare për grupet në nevojë dhe studentët e ekselencës, të cilët kanë një notë mesatare vjetore 9 (nëntë) ose më të lartë. Po kështu përfitojnë bursë fëmijët e policëve të vrarë në krye të detyrës, fëmijët jetimë të ardhur nga familje me të ardhura të ulëta. <i>Annex Nr. 2.13- Të dhënat mbi kriteret e pranimit të programit të studimit, tarifat dhe modalitetet financiare për studentët.</i> <i>Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit, pika 8, germa g.</i>
Konkluzione	<i>IAL ka hartuar dhe zbaton procedura e politika të qarta për pranimin e studentëve në programet akademike dhe përzgjedhjen e tyre në bazë të legjisllacioniut në fuqi. Një kujdes i vecantë tregohet për matjen e përparimit të studentëve duke zbatuar forma të ndryshme të vlerësimit si gjatë vitit akademik ashtu edhe në përfundim të tij. Universiteti "Fan Noli" ka një legjisllacionin të qartë institucional për transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve</i>

	<i>dhe diplomimin në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studenti njihet me rregulloren e programit, e cila përcakton kriterit e kalimit nga një vit akademik në tjetrin në varësi të përmbushjes së kërkesave akademike. IAL vë në dispozicion informacion të detajuar rreth përparimit akademik. Informacioni zyrtar mbi notat është pjesë e sistemit të menaxhimit të universitetit. Me përfitimin e statusit të studentit, çdo student pajiset me adresën e tij elektronike në sistemin Pitagora që është një ndër format e komunikimit midis studentit dhe institucionit, si edhe me fjalëkalimin për tu informuar dhe regjistruar informacionet më të rëndësishme, siç janë notat apo mungesat në mësim. Këto informacione studenti mund të aplikojë për të marrë edhe në sekretari. Falë Sistemit Interaktiv Fan Noli EIS, stafi akademik me kohë të plotë dhe studentët kanë akses në sistemin e menaxhimit jo vetëm për të regjistruar notat por edhe njohur me rezultatet e arritura si edhe për të verifikuar ecurinë e studentëve dhe për të bërë këshillimet e nevojshme mbi progresin akademik. Komunkimi midis studentëve dhe pedagogëve kryhet edhe përmes orarit të pritjes, të përcaktuara qartë në DSHS për çdo lëndë. Ndërsa informimi i studentëve kryhet zakonisht nëpërmjet sekretarive mësimore dhe korrdinatorit të masterit, i cili i mbështet dhe informon studentët lidhur me detyrimet e pashlyera apo problematike të ndryshme me të cilat ata mund të ndeshen. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, nenet 86-87.</i> <i>Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit, pika 13</i> <i>Annex Nr. 2.2 -Rregullore e Njësisë Kryesore nenet 14, 69.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në	Sekretaria Mësimore ofron informacion mbi procedurat e njohjes së diplomës apo të krediteve të përfituara nga institucione të tjera në

lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	bazë të kuadrit ligjor të miratuar nga Ministria Arsimit dhe Sportit, por edhe informacioni shtesë për studentët e huaj duke shpjeguar udhëzime mbi procedurat e transferimit kriteret - siç u sqarua më lart - për njohjen e krediteve, duke informuar më pas studentin për kreditet e njohura nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Broshura e vënë në dispozicion të studentëve përmban informacion të plotë dhe i bashkëngjitet aksesit elektronik që ka studenti dhe i lehtëson këtij të fundit mundësinë e komunikimit me çdo zyrë shërbimesh, siç janë Zyra e Këshillimit të Karrierës apo sekretaria mësimore. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, nenet 89-91.</i> <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit “Fan S. Noli”, nenet 70, 72.</i> <i>Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit, pika 13</i> <i>Annex Nr. 2.2 -Rregullore e Njesisë Kryesore neni 50.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Statuti dhe Rregullorja e IAL së bashku me rregulloren e fakultetit dhe atë të programit informon studentët për kriteret dhe procedurat e vlerësimit të njohurive dhe aftësive gjatë programit të studimit. Universiteti “Fan Noli” operon me sistemin Evropian të Arsimit të Lartë të Krediteve si njësi matëse e ngarkesës akademike. Mënyrat e vlerësimit të njohurive të programit si edhe kriteret e vlerësimit janë përcaktuar në Rregulloren e Programit, sikundër u ilustrua më lart. Në një lëndë tipike dijet e përfituara vlerësohen sipas këtij klasifikimi: a) aktivizimi në leksione dhe seminare; b) Provimi Përfundimtar; c) Pjesëmarrje aktive e studentit në klasë; d) Komponentë të tjerë si detyra kursi, projekte studimore. Këto kriteret janë të pasqyara edhe në faqen online të universitetit. <i>Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit “Fan S. Noli”, Kreu VIII.</i> <i>Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit, pika 14.</i> <i>Annex Nr. 2.2 -Rregullore e Njesisë Kryesore Kreu IV.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	DSHS informon studentët në lidhje me kriteret dhe parakushtet që përcaktojnë kriteret pranimit në procesin e diplomimit – i.e. detyrim të pashlyer, si edhe përfundimin e të gjitha kurseve - kriteret dhe procedurat për zbatimin e projektit të diplomimit. Informimi i studentëve lidhur me këto kërkesa dhe procedura është detyrë e departamentit. Studentët ftojnë të përzgjedhin temën e masterit pas muajit të dytë të vitit të dytë pasi njihen me ngarkesën akademike të atij viti.. Studentët paraqesin një dokument që i kanë kryer të gjitha detyrimet prej 120 ECTS për të marrë diplomën e masterit shkencor. <i>Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit, pika 14.</i>

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni organizon dhe zhvillon takime me studentët bachelor për tu ofruar atyre informacionin e nevojshëm mbi programet e studimit në programet master. Kjo realizohet kryesisht nga koordinatori i masterit. IAL merr pjesë në panairë të organizuara dhe në mediat sociale ku ofron udhëzime dhe informacione për kandidatët e mundshëm <i>Annex Nr. 1.4- Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerzëore.</i> <i>Annex Nr. 3.10- Praktikat e promovimit dhe informimit mbi programet e studimit.</i>			
Konkluzione	<i>IAL ofron mjete të ndryshme për njohjen e programit nga ana e studentëve dhe këto përfshijnë si transparencën online me informacion të hollësishëm për programin e studimit, javën hyrëse ku koordinatori dhe pedagogët pjesmarrës japin informacionin e nevojshëm dhe zyrën pranimit që shërbejnë si pikë reference për studentëve e programit të studimit për të dhënë një informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin në fjalë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Në informacionin e masterit përcaktohen karakteristikat e programit të ciklit të dytë ku studentët gjejnë të gjithë informacionet e nevojshme mbi programet e studimit, siç janë kohëzgjatja e programit, tarifat e studimit, përbërja e lëndëve etj. Informacioni synon kryesisht studentët e degëve të filozofisë, Sociologjisë dhe Adminsitrimin, Politikat Sociale, etj. Si nëpërmjet faqes online ashtu edhe broshurave, titëve të hapura, poanairëve, etj. Zyra e Këshillimit të Karrierës informon studentët mbi mundësitë e punësimit pas




	përfundimit të programit. <i>Annex Nr. 1.4- Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerzëore.</i> <i>Annex Nr. 3.11- Praktikë e informimit të studentëve mbi programin e studimit.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentit i ofrohet i gjithë informacioni i nevojshëm si syllabuset që në javën e parë të studimeve, ndërsa çdo student ndiqet nga një pedagog që është pjesë e departamentit. Studentëve ky informacion mund ti jepet online por edhe i printuar në guidën e studentit, e cila u vihet në dispozicion studentëve që në fillim të vitit akademik. Studentëve u krijohet mundësia për tu takuar me pedagogët dhe për të marrë më shumë informacion mbi programin. Studentët informohen gjithashtu edhe për akreditimin e programeve dhe të institucionit dhe vlefshmërinë e diplomes nëpërmjet koordinorit të programit. <i>Annex Nr. 2.8- Programet Lëndore të Programit të Studimit.</i> <i>Annex Nr. 3.28- Guida e Studentit.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Koordinatori informon studentët lidhur me mundësitë e punësimit që në fillim të programit, si edhe ofron modele suksesi nëpërmjet angazhimit të Alumni të Programit. IAL ka Zyrën e Planifikimit të Karrierës, e cila informon studentët –sikunder u theksua edhe në takimet me studentët dhe me Përfaqësues të Zyrës së Karrierës–në lidhje me nevojat e tregut të punës duke ofruar seanca këshillimore për studentët që duhet të njihen me mundësitë e punësimit apo praktikave që mund të ndjekin pranë institucioneve të ndryshme. Një nga aktivitetet më të rëndësishme të Zyrës së Karrierës është organizimi i Sesioneve Informative, guidës së përvitshme të Karrierës, i cili bashkon përfaqësues të institucioneve publike, biznesit, por edhe nëpërmjet seminareve të hapura dhe tryezave të rrumbullakëta për ti orientuar sa më drejt studentët rreth tregut të punës. <i>Annex Nr. 3.2- Tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktikë.</i> <i>Annex Nr. 3.6- Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit.</i> <i>Annex Nr.3.11- Praktikë e informimit të studentëve me programin e studimit</i> <i>Annex Nr. 3.28 -Guida e Studentit.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe	Një përshkrim i plotë i ambienteve të logjistikës ofrohet që në fillim të programit, ndërsa gjatë vizitave të organizuara në institucion, studentët apo kandidatët informohen mbi shërbimet e ofruara për

i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	studentët, informacionet lidhur me programin e studimit, logjistika institucionale, etj. Ndërsa informacionet më të rëndësishme publikohen edhe në faqen zyrtare të institucionit, si edhe në stendat e departamentit. Siç u theksua edhe në takimin me Stafin Akademik të Programit, këto informacione ofrohen edhe gjatë ditëve të hapura të organizuara në fillim të çdo viti akademik për këtë qëllim nga të gjitha strukturat e IAL në shërbim të studentit por edhe nga kordinatori i programit gjatë javës së parë në prezantimin e çdo lënde. Annex Nr. 4.7- Tabela e të dhënave strukturore në funksion të programit të studimit. Annex Nr.2.5- Rregullorja e Programit të Studimit. Annex Nr. 5.1 -http://www.unkorce.edu.al/sq.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Pasi studentët regjistrohen në Universitetin “Fan Noli”, sigurojnë një emër përdorimi dhe kod për të patur akses në listën e tyre të notave, mungesat e kryera, si edhe situatën e tyre financiare. Kjo procedurë kryhet në sistemin e menaxhimit online dhe akses i mundësohet në çdo ambient nga ku mund të ketë lidhje me internet. Ndërkohë të gjitha zyrat dhe organet menaxheriale të universitetit ndjekin politikën e dyerve të hapura për studentët me qëllim ndihmën e studentëve si në procesin akademik ashtu edhe në jetën studentore. Annex Nr. 2.5- Rregullore e Programit të Studimit. Annex Nr. 1.4- Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore. Annex Nr.3.11- Praktikë e informimit të studentëve me programin e studimit Annex Nr.3.10- Praktikë e informimit të studentëve mbi programet e studimit Annex Nr. 5.1 -http://www.unkorce.edu.al/sq.
Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit janë publike dhe mund të aksesohen nga studenti si online ashtu edhe nëpërmjet broshurave apo edhe komunikimit me kordinatorin e programit dhe stafin akademik të programit. Përtej programit të studimit, organizohen me ndihmën e partnerëve institucionalë edhe panairë për tu dhënë mundësi studentëve të njohin tregun e punës. Programet e studimit dhe syllabusët përkatës janë në dispozicion të studentëve duke përfshirë si format e vlerësimit objektivat mësimore që pritet të arrihen në përfundim të kursit, por edhe mënyrën e vlerësimit të përmbushjes së këtyre objektivave formuese.</i>
Shkalla e	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet

përmbyshjes së standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Në bazë të legjislacionit në fuqi, statistikën mbi numrin e studentëve, shpërndarjen sipas programeve, notat e marra, studentët e diplomuar dhe ata të dalluar, përgatiten çdo vit nga Zyra e Protokoll Arkivës, si në formatin e printuar ashtu edhe në atë elektronik. Këto të dhëna dokumentohen në “Raportin Vjetor”, i cili përgatitet nga Zyra e Karrierës si pjesë e detyrimit ligjor të IAL. Të dhënat që përpunohen nga Zyra e Karrierës përfshijnë punësimin e studentëve, si edhe përputhshmërinë e punësimit me drejtimin e diplomimit. <i>Annex Nr. 4.4-Tabela e të dhënave të regjistrimit në vite akademike</i> <i>Annex Nr. 4.6- Tabela përmbledhëse për punësimin e studentëve të programit</i> <i>Annex Nr. 1.10- Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit TIK</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sistemi i menaxhimit të të dhënave mundëson përditësimin dhe hedhjen e të dhënave personale të studentëve në performancën akademike dhe në situatën financiare, që nga momenti i regjistrimit deri tek diplomimi përfshirë edhe studentët e regjistruar dhe të larguar. Në këtë mënyrë krijohet një tablo në kohë reale për progresin e studentëve, situatën e atyre që janë në programet e studimit, atyre që janë shkëputur përkohësisht apo përgjithmonë. Ky përditësim ndihmon Sekretarinë Mësimore që të ofrojë të dhëna të sakta që nevojiten si për zbatimin e legjislacionit në fuqi ashtu edhe raporteve apo studimeve të kryera nga vetë institucioni. <i>Numri i studentëve për dy vite akademike vijon si më poshtë:</i> <i>Viti akademik 2022-2023: 20 studentë</i> <i>Viti akademik 2023-2024: 12 studentë</i>

	Annex Nr. 4.4-Tabela e të dhënave të regjistrimit në vite akademike Annex Nr. 1.10- Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit TIK
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Për të mbrojtur të dhënat personale të studentëve, të cilat menaxhohen nga sekretaria mësimore platformës së brendshme, aksesit u lejohe vetëm personave të autorizuar si në departamentet ashtu edhe zyrat e tjera në bazë të rregulloreve dhe përgjegjësisë përkatëse dhe mund të aksesohet vetëm nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Sekretaria mësimore e përdor këtë platformë jo vetëm për të hedhur të dhëna por edhe për të vënë në dispozicion të dhënat që nevojiten për analizat, raportet apo hartimin e strategjive të institucionit Annex Nr. 1.10- Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit TIK
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Për të kryer auditimin e brendshëm të njësive administrative, institucioni ka ngritur një grup për auditimin e brendshëm, i cili ka si objektiv kontrollin në mënyrë periodike të procedurave dhe rregullave të përshkruara në rregulloren e funksionimit të zyrave administrative. Ky grup përpilon një raport vjetor ku përfshihen mangësitë e vërejtura si edhe ofrohen sugjerime për përmirësimin e tyre duke u udhëhequr nga përpjekjet për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Annex Nr. 1.10- Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit TIK, Kreu II
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të	Siç u përmend më lart, Zyra e Regjistrimit përgatit çdo vit dhe vë në dispozicion të Departamentit përkatës të dhënat e nevojshme për hartimin e raporteve dhe analizave përsa i takon numrit të studentëve të regjistruar dhe diplomuar, apo shkëputur nga programet e studimit. Ndërkohë Zyra e Karrierës siguron bazën e nevojshme të të dhënave për studentët e diplomuar duke kontribuar në hartimin e raporteve të ndryshme dhe ofrimin e një pasqyre të studentëve të diplomuar, punësimit të tyre dhe profilet e punësimit. Nga të dhënat e kësaj Zyre vërehet se numri i

përmirësimin të këtyre treguesve.	studentëve të punësuar plotësisht në profilin e tyre është 100%. <i>Annex Nr. 4.4-Tabela e të dhënave të regjistrimit në vite akademike</i> <i>Annex Nr. 3.8- Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë 2022-2023</i> <i>Annex Nr. 4.12-Tabela e cilësisë në hyrje dhe në dalje e studentëve</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni bën një punë të vazhdueshme me ndihmën e zyrave administrative për të mbledhur, administruar, përditësuar dhe ruajtur të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimin të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në nenin 17 të Statutit, IAL saknksionon pjesmarrjen e studentëve në vendimmarrjet institucionale. Këshillat Studentore në nivel fakulteti janë organizata të pavarura, përfaqësuesit e të cilave zgjidhen nga vetë studentët dhe përfaqësojnë interesat e tyre me një mandat 2-vjeçar. Studentët përfaqësohen në të gjitha nivelet vendimmarrëse të IAL siç janë Senati Akademik, Bordi i Administrimit, sikundër edhe ushtrojnë detyrën e vëzhguesit në procesin zgjedhor në UNIKO.Në Statutin e Këshillit parashikohet edhe përfshirja e një studenti të zgjedhur nga Këshillit Studentor në komisionin disiplinor, ndërsa parashikohet shmangia mundshme e konfliktit të interesit në përzgjedhjen e studentëve në instancat vendimmarrëse të institucionit. <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, neni 17, pika 6; neni 29, pika 4; neni 33, pika 2; neni 79; neni 80; neni 85 pika 1.</i> <i>Annex Nr. 2.2- Rregullore e Njësisë Kryesore, neni 76</i>




	<i>Annex Nr. 1.17- Rregullore e Këshillit Studentor</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	IAL Fan Noli saknsionon në aktet ligjore institucionale të drejtën e studentëve për tu përfaqësuar në vendimmarrje në instanca si: Senati Akademik, grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, Bordi i Etikës, si edhe dhe Bordi i Administrimit. Një student është gjithashtu pjesë e grupit të punës për hartimin e raportit të Vlerësimit të Brendshëm gjatë procesit të akreditimit siç u pa edhe në takimin me Grupin e Punës për Hartimin e RVB. <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, neni 17, pika 6; neni 29, pika 4; neni 33, pika 2; neni 79; neni 80; neni 85 pika 1.</i> <i>Annex Nr. 2.2- Rregullore e Njesisë Kryesore, neni 76</i> <i>Annex Nr. 3.4- Lista e NJSBC</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Si anëtarë të Senatit Akademik dhe grupeve të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që janë organet kompetente për hartimin dhe kontrollin e zbatimit të programit, studentët janë pjesë e procesit të hartimit dhe përmirësimit të programeve falë edhe pyetësorëve për vlerësimin e lëndës dhe pedagogëve. Studentët kontribuojnë gjithashtu edhe nëpërmjet mendimeve që japin në anketat pas përfundimit të lëndës dhe në takimet me pedagogët përkatës <i>Annex Nr. 3.13- Pyetësori Studentor dhe raporti përkatës.</i> <i>Annex Nr. 3.18- Shembulli i orëve të hapura</i> <i>Annex Nr. 3.4- Lista e NJSBC</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njesisë/pedagogut përgjegjës.	Studenti ka të drejtën e ankimimit për notën e provimit brenda 48-orëve nga marrja e notës dhe i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit. Përgjegjësi i departamentit merr në shqyrtim ankesën e dorëzuar nga studentët por edhe mbledh të gjitha të dhënat përkatëse lidhur me ankesën apo kërkesën e paraqitur nga studenti dhe e paraqet pranë pedagogut të lëndës, i cili rishikon vlerësimin nëse kjo është e arsyeshme. Në rast se përgjegjësi i departamentit e shikon të pamundur zgjidhjen e problemit, atëhere brenda 48 orëve vë në dijeni dekanin, i cili ngre një komision ad-hoc për shqyrtimin e ankesës. Sikundër GVJ u inofrmua në takimin me Studentët e Programit, keta të fundit nëpërmjet Këshillit Studentor paraqesin ankimet e tyre për çdo element të aktivitetit të tyre në institucion, të cilat

	merren në shqyrtim nga instancat përkatëse institucionale. Annex Nr. 1.2- Rregullore e Universitetit të Korces, neni 83. Annex Nr. 2.2- Rregullore e Njesisë Kryesore, neni 67-68. Annex Nr. 2.5- Rregullore e Programit, pika 14			
Konkluzione	Universiteti "Fan Noli" i kushton rëndësi mbledhjes së informacionit nga ana e studentëve dhe kjo arrihet si nëpërmjet pyetësorëve të lëndës ashtu edhe procesit të ankimit apo prurjes së sugjerimeve nga ana e tyre. Kjo realizohet edhe falë përfshirjes dhe angazhimit të studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Ky proces zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe me përfshirjen e të gjitha organeve të universitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Specialistët e Zyrave të Informacionit, Këshillimit të Karrierës, si edhe ata të departamentit të FSHNSHH ofrojnë informacionin e plotë të nevojshëm për studentët, si edhe mbajnë kontakte të vazhdueshme me ta, për të siguruar një shërbim sa më të mirë ndaj tyre. Të gjitha shërbimet dhe informacionet janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Institucionit, si edhe në rregulloren e studimeve ndërsa përveçse ndjekin të gjithë progresin akademik të studentëve, këto instanca ofrojnë edhe informacion të plotë për palët e treta në kuadër të transparencës, si nëpërmjet dokumentacionit të publikuar ashtu edhe online http://www.unkorce.edu.al/sq. Annex Nr. 1.4-Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore Annex Nr. 1.5- Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional.

	<i>Annex Nr. 1.10- Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit TIK</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Zyra e Informacionit, Këshillimit të Karrierës, rregullorja e programit në seksionin e “Formave të Studimit dhe Vlerësimit të Programit” si dhe pedagogët e programit informojnë studentët përmes emaileve, takimeve në zyrë, broshurave apo përmes dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet sistemit e brendshëm digjital, ditës së orientimit për studentët, por edhe faqes së internetit, informacionet lidhur me karakteristikat e programit të studimit, që përditësohen në kalendarin akademik https://unkorce.edu.al/ep-content/uploads/2022/09/udherefyesi2022.pdf . Studentët mund të kenë edhe takim me pedagogët apo pjestarët e stafit akademik përgjegjës për programin, ndërsa informacioni më i detajuar lidhur me planin mësimor, syllabus i lëndëve, datat e provimeve etj ofrohet nga si edhe koordinatori i programit. <i>Annex Nr. 2.5- Rregullorja e Programit, pika 14</i> <i>Annex Nr. 3.28- Guida e Studentit.</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit të Karrierës fokusohet në përthithjen e nevojave të tregut të punës, praktikave profesionale për këshillimin e studentëve dhe strukturave akademike të universitetit lidhur me këto nevoja, si edhe ndan këtë informacion me departamentet përkatëse, por edhe koordinatoret e programeve, në mënyrë që programet e studimit të përgatisin studentë me profile sa më të kërkuara në tregun e punës. Kjo Zyrë i ofron studentëve këshillat e nevojshme lidhur me mundësitë e karrierës nëpërmjet takimeve individuale, panairove dhe workshopeve tematike të organizuara për këtë qëllim, si edhe nëpërmjet informacionit të publikuar lidhur me analizat mbi tregun e punës, të cilat publikohen në të gjitha kanalet e institucionit në bashkëpunim me Zyrën e Informacionit http://www.unkorce.edu.al/sq. <i>Annex Nr. 1.4-Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore</i> <i>Annex Nr. 2.10- Marrëveshje Bashkëpunimi në mbështetje të Praktikave Profesionale.</i> <i>Annex Nr. 3.5- Tabela e Institucioneve bashkëpunuese për praktikat.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët	Në database të Zyrës së Karrierës dhe Alumni përfshihen të gjithë studentët e diplomuar në të gjitha nivele akademike, si edhe

pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	identifikohet niveli i punësimit për këta studentë duke e integruar në analizën e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore që përgatitet në përfundim të çdo viti akademik në bashkëpunim me Drejtorinë e Kurrikulës duke përfshirë: statusin e punësimit, institucionet e punësimit, si edhe rekomandimet që ata mund të kenë në lidhje me përmirësimin e programit. Ky informacion ndahet me drejtuesit e programeve, dekanët dhe rektoratin për të parë se çfarë mund të përmirësohet në të ardhmen. Kontaktet me industrinë dhe institucionet mbahen nga kjo Zyrë falë edhe kontakteve që ata kanë në mënyrë të vazhdueshme me Alumni por edhe kontakteve të rregullta që mbahen me institucionet publike dhe kompanitë ku janë punësuar studentët <i>Annex Nr. 1.4-Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore</i> <i>Annex Nr. 3.12- Studimi periodik i tregut të punës.</i> <i>Annex Nr. 4.6- Tabela përmbledhëse për punësimin e studentëve të programit të studimit.</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti "Fan Noli" ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve siç janë koordinatori i programit apo edhe pedagogët e lëndës të cilët së bashku me zyrat ndihmëse ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët. Studentët informohen lidhur me mundësitë e tregut të punës, ndërsa të gjitha strukturat e përhershme të IAL janë hapura studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe



monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në dokumentet institucionale të IAL sië janë Statuti, Rregullorja e Brendshme e FSHNH janë përcaktuar qartë procesi i mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit përfshirë edhe integrimin e teknologjive të avancuara, rishikimin e programeve mësimore, jo vetëm për të sansksionuar këto aktivitete por edhe për t'iu përgjigjur nevojave të tregut është edhe pjesë e strategjisë së institucionit. Për aplikimin e këtyre strategjive, stafi institucionit merr pjesë në trainimet e organizuara nga IAL siç janë ato për Google Classroom, Google Meet dhe së fundmi platforma Teams Office 365. Këto trajnime fokusohen tek mobiliteti i stafit jo vetëm për të rritur kapacitetet profesionale të tij, por edhe për të krijuar më shumë mundësi për ndërkombëtarizim. Aktualisht institucioni ka krijuar një fond të brendshëm për të mundësuar pjesëmarrjen apo botimet e pedagogëve në revista me impakt faktor dhe ky fond arrin deri në 400 euro në vit. Punë e veçantë bëhet për trajnimin e stafit në mënyrë periodike dhe nxitjen e zhvillimit të vetëvlerësimit kritik, sidomos me pedagogët e rinj të cilët trajnohen për mënyrën e përgatitjes së programeve, kurrikulave dhe shpjegimin e rregulloreve përkatëse. Monitorimi dhe vlerësimi i personelit akademik realizohet në disa drejtime: a) Përgjegjësi i departamentit bazuar në rregulloren e FSHNH; b) Pyetësorët si online ashtu edhe në formën e shkruar si për lëndën e ofruar ashtu edhe për format e mësimdhënies c) Vetëvlerësimi i hartuar nga vetë pedagogu, ku shpjegohen jo vetëm problemet dhe arritjet por edhe metodat e përdorura për ti kapërcyer ato; d) Opinioni i studentëve në bashkëbisedimet dhe format e tjera jo formale të vlerësimit, por edhe nëpërmejt pyetësorit studentor për cilësinë nga SKVI, bazuar Statuti i UNIKO, të cilin studentët mund ta aksesojnë online. <i>Annex Nr. 2.2-Rregullorja e Njesisë Kryesore</i> <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu IX</i> <i>Annex Nr. 2.3- Rregullore e Njesisë Bazë</i> <i>Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitutcional: Përshkrimi i veprimtarisë së Njesisë së Sigurimit të Cilësisë.</i> <i>Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së Universitetit Universitetit të</i>

	Korces me vendim Senati Nr. 300 dt 10.07.2020 Annex Nr. 1.3- Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit "Fan S. Noli" 2022-2027
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Departamenti si njësi bazë mësimore-kërkimore e UNIKO është në çdo fakultet, struktura përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin në mënyrë të vazhdueshem të cilësisë. Drejtuesi i departamentit drejton punën për hartimin dhe përmirësimin e kurrikulave për të gjitha ciklet mësimore dhe ndjek zbatimin e tyre duke mbajtur dokumentacionin e veprimtarisë mësimore dhe shkencore. Për hartimin e raportit vjetor drejtuesi ndihmohet nga Drejtuesi i Grupit Mësimor dhe Kërkimor si edhe koordinatorët e programit të studimit, të cilët pasqyrojnë mendimin e grupit mësimor-kërkimor nëpërmjet raporteve distiluese nga format e vlerësimit të pedagogëve të përmendura më lart. Rezultatet e raporteve u vihen në dispozicion rektoratit, drejtuesve të departamentit, dhe përfshihen në raportin vjetor të departamentit, ku paraqiten vlerësimet për stafin akademik dhe ndimës-akademik, si edhe trajnimet e ofruara. Të gjitha këto vlerësime diskutohen në prani të përgjegjësit të departamentit. Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu IX Annex Nr. 2.3- Rregullore e Brendshme e Njesisë Bazë Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional: Përshkrimi i veprimtarisë së Njesisë së Sigurimit të Cilësisë. Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së Universitetit Universitetit të Korces me vendim Senati Nr. 300 dt 10.07.2020 Annex Nr. 1.3- Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit "Fan S. Noli" 2022-2027
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	IAL inkurajon përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, si edhe ofrimin e sugjerimeve nga studentët duke e konsideruar si një shtytës për të arritur objektivat e mësimdhënies. Këto pyetësorë jo vetëm që përmirësojnë metodologjitë mësimore, por edhe sjellin në vëmendje pakënaqësitë e studenteve, ndërsa mënyra për ta shprehur shqetësimet apo sugjerimet e studentëve ekziston nëpërmjet procesit të ankimimit pranë Dekanit të Studentëve. Studentët janë të përfshirë edhe në komisionet e sigurimit të cilësisë NJSBC/GGB si edhe përfaqësohen në Senatin Akademik me dy anëtarë, në Këshillin e Etikës dhe Borrdin e Administrimit me nga një anëtar Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu IX Annex Nr. 2.3- Rregullore e Njesisë Bazë



	Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional: Përshkrimi i veprimtarisë së Njesisë së Sigurimit të Cilësisë. Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së Universitetit Universitetit të Korces me vendim Senati Nr. 300 dt 10.07.2020 Annex Nr. 1.3- Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli” 2022-2027
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në kuadër të transparences institucionale, IAL publikon raportet përfundimtare të akreditimit të programeve të studimit në faqen zyrtare të IAL duke përfshirë edhe raportet e grupit të vlerësimit të brendshëm. Departamenti arshivon planet dhe programet mësimore, përditëson listën e publikimeve të stafit akademik, pjesëmarrjen në konferenca shkencore, si edhe publikon analizat vjetore të punës ku përfshihen rezultatet e vlerësimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe universiteti. Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu IX Annex Nr. 2.3- Rregullore e Njesisë Bazë Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional: Përshkrimi i veprimtarisë së Njesisë së Sigurimit të Cilësisë. Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së Universitetit Universitetit të Korces me vendim Senati Nr. 300 dt 10.07.2020 Annex Nr. 1.3- Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli” 2022-2027
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Për të nxitur zhvillimin profesional, IAL mundëson për vlerësimin e stafit duke përcaktuar objektivat e tyre për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor nëpërmjet vlerësimit të arritjeve për çdo pedagog për tu konsideruar se përmbushin pritshmëritë, si edhe në kuadër të strategjisë së zhvillimit të IAL. Koordinatori i departamentit ia percjell këto raporte dekanit, duke i kërkuar pedagogëve që të vlerësojnë se si janë plotësuar këto objektiva, ofron trainimet e nevojshme për ti nxitur pozitivisht performancën individuale të çdo pedagogu dhe vendos për promovimin e pdegagogut dhe mbështjetjen për kërkimet shkencore, pjesëmarrjen në konferenca etj. Këto vlerësime i shtohen atyre nga kolegët, studentët, takimet personale me stafin akademik, etj. Megjithatë GVJ vërejti se pasi raporti i vlerësimit shkon në dekanat, atëherë nuk ka një procedurë që kontrollon ecurinë apo zbatimin e rekomandimeve të këtyre raporteve, apo një praktikë për përkthimin e problemeve të ngritura në hapa konkretë - si për shembull trajnime, tryeza të rumbullakëta me tematika specifike




	apo ndarje të eksperiencës pozitive - nga ana e dekanatit apo e njësisë bazë për përmirësimin e performancës akademike. Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu IX Annex Nr. 2.3- Rregullore e Njësisë Bazë Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional: Përshkrimi i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë. Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së Universitetit Universitetit të Korces me vendim Senati Nr. 300 dt 10.07.2020 Annex Nr. 1.3- Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli” 2022-2027			
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet krijimit të strukturave përkatëse siç janë GVB dhe NjSBC, metodologjitë dhe mjetet përkatëse për të zhvilluar këtë monitorim, si edhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave të monitorimit, trajnimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të performancës së stafit.</i> <i>Megjithatë GVJ vërejtë se pasi raporti i vlerësimit shkon në dekanat, atëherë nuk ka një procedurë që kontrollon ecurinë apo zbatimin e rekomandimeve të këtyre raporteve, apo një praktikë për përkthimin e problemeve të ngritura në hapa konkretë - si për shembull trajnime, tryeza të rrumbullukatëa me tematika specifike apo ndarje të eksperiencës pozitive - nga ana e dekanatit apo e njësisë bazë për përmirësimin e performancës akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë	Siç u shpjegua më lart Fan Noli ka strukturat e nevojshme të sigurimit të cilësisë por edhe procedurat e zhvilluara për këtë qëllim në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Kjo sanksionohet edhe në Statutin e Universitetit ku përcaktohet roli i strukturave bazë siç janë GVB



(SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	dhe NJSBC, por edhe nën-strukturave ndihmëse siç janë Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, Rrjeti i Cilësisë i cili përbëhet nga Sektori i Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional dhe është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulës. Të gjitha këto struktura synojnë përmirësimin e mëtejshëm të punës, ku rritja e cilësisë akademike, mësimdhënia por edhe shërbimet paraqiten si objektiva strategjike. Për të mbështetur më tej zbatimin e këtyre procedurave GVB dhe NJSBC kanë hartuar edhe rregulloren përkatëse si edhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe Rregulloren për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kontrolli i sigurimit të cilësisë dhe përgatitja e raporteve përkatëse realizohet një herë në vit dhe synon të përmbushë objektivat strategjikë të IAL në drejtim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu IX</i> <i>Annex Nr. 3.4- Lista e NJSBC</i> <i>Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional.</i> <i>Annex Nr. 1.24- Këshilli i Administrimit të Universitetit të Korces, me Vendimin Nr. 2, dt 06.05.2008</i> <i>Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së Universitetit Universitetit të Korces me vendim Senati Nr. 300 dt 10.07.2020</i> <i>Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së UNIKO</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Struktura e sigurimit të cilësisë NJSBC funksionon në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, statutin e insitucionit dhe rregulloret përkatëse të harmonizuara me Manualin e Cilësisë. Ajo funksionon në përputhje me nenin 73 dhe 74 të Stautit të Universitetit përbëhet nga një koordinator i çdo njësie kryesore, eksperti i jashtëm dhe një përfaqësues i studentëve. NJSBC monitoron por edhe ofron ekspertizë si nëpërmjet burimeve të brendshme, por edhe ftuar ekspertë të jashtëm, duke u bazuar në analizat dhe raportet e cilësisë të hartuara siç u tha më lart nga çdo departament duke patur një rol bashkërendues në procesin e përmirësimit të cilësisë. Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni planifikon organizimin e vlerësimit të brendshëm institucional dhe për këtë qëllim ngrihet NJSBC e përbërë nga 8 anëtarë: 4 nga personeli akademik, i njësive kryesore, 2 përfaqësues nga administrata, një student dhe një ekspert i jashtëm. NJSBC në bashkëpunim me fakultetet/departamentet organizon e finalizon formën e vlerësimit dhe performancën e pedagogut (<i>Takim me përfaqësues të NJSBC</i>). Të dhënat përpunohen nga koordinatori i NJSBC dhe përfshijnë të gjitha format e vlerësimit për pedagogun

	dhe përfshihen në raportin përfundimtar të departamentit, i cili është i aksesueshëm në faqen zyrtare të IAL. NJSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësive aplikon, koordinon dhe finalizon të gjithë procedurën e akreditimeve institucionale, Planin Strategjik Pesëvjeçar si edhe Planin e Veprimit brenda institucionit. Për të patur një përjasje sa më të mirë me nevojat e tregut të punës, në këtë analizë dhe plan-masash përfshiehn edhe përfaqësues të jashtëm nga institucionet publike apo sektori privat. <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu IX</i> <i>Annex Nr. 3.4- Lista e NJSBC</i> <i>Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional.</i> <i>Annex Nr. 1.24- Këshilli i Administrimit të Universitetit të Korces, me Vendimin Nr. 2, dt 06.05.2008</i> <i>Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së Universitetit Universitetit të Korces me vendim Senati Nr. 300 dt 10.07.2020</i> <i>Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së UNIKO</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Sistemi i sigurimit të cilësisë përfshin një sërë mekanizmesh të cilat veprojnë duke iu përgjigjur parimit Njesi-Mekanizëm-Periudhë, ku përfshien planet vjetore dhe ato të veprimit, analizat e pyetësorëve dhe anketimeve, përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e jashtme. Manuali i Cilësisë është dokumenti bazë për NJSBC për të siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe hartohet bazuar në një sërë mekanizmesh, sikundër u përmend më lart, ndërsa fokusohet veçanërisht në pyetësorët e krijuar si për lëndët dhe mësimdhënien, ashtu edhe për tematika të veçanta në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet nëpërmjet proceseve të akreditimit, dhe Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë është dokumenti kryesor për këtë qëllim në përputhje me nenin 104 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Për të plotësuar sa më mirë rekomandimet e lëna gjatë akreditimeve, NJSBC harton një plan që ndjek në vijimësi zbatimin e këtyre rekomandimeve. <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu III, neni 28.</i> <i>Annex Nr. 3.8- Analiza vjetore e veprimtarisë së Njesisë Bazë</i> <i>Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional.</i> <i>Annex Nr. 4.28- Tabela e të dhënave për kualifikimin kërkimor dhe shkencor</i>

	Annex Nr. 3.14- Pyetësi i stafit akademik/Raport Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së UNIKO: 7 modele formularësh (fq 17-20), si edhe shtojcat			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Strukturat e ngarkuara për sigurimin e cilësisë gjenerojnë analiza dhe raporte të vazhdueshme duke përfshirë format e vlerësimit të pedagogëve të përmendura më lart, të cilat realizohen nëpërmjet hartimit të Raportit Vjetor të Vlerësimit të Brendshëm (RVVB) ku përfshihen arritjet dhe vlerësohen nevojat për përmirësimin e punës. Raporti i paraqitet Senatit akademik duke përfshirë edhe rekomandimet përkatëse të NjSBC për përmirësimin e mëtejshëm të punës. Për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë, secili anëtar i stafit akademik përveç mësimdhënies është i angazhuar edhe në kërkimin shkencor, në grupet e punës akademike dhe në projekte mobiliteti si Erasmus+ dhe kjo veçanërisht për pedagogët e rinj, për të financuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore dhe akademike Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu III, neni 28. Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional. Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së UNIKO			
Konkluzione	Universiteti Fan Noli harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit duke harmonizuar forma të ndryshme të monitorimit, si anketat e studentëve, vlerësimin e pedagogëve, rezultate të cilat harmonizohen në raportet përkatëse dhe zbatohen me udhëzimet e nevojshme nga strukturat e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------




Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Departamenti mbetet struktura përgjegjëse për mbarrëvajtjen e programeve përkatëse të studimit. Procesi i mbikëqyrjes së programeve të studimit dhe stafit akademik bazohet në analizën e objektivave të vendosura si në nivel individual ashtu edhe në nivel departamenti për tu plotësuar gjatë vitit akademik për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Në përfundim të vitit akademik nga dekanati i kërkohet NJSBC hartimi i raporteve në nivel departamenti dhe fakulteti, ku përshkruhen të gjitha aktivitetet e kryera për përmbushjen e këtyre objektivave, si edhe propozimet për përmirësimin e programeve mësimore, të cilat miratohen përfundimisht nga Senati Akademik. IAL kryhen analiza vjetore për vlerësimin e ecurisë së studentëve në programet e studimit, ku përfshihen të dhëna për aspektet akademike dhe performancën e studentëve, nivelin e kalueshmërisë, shkallën e diplomimit dhe punësimit, etj, të cilat pasi mblidhen nga strukturat përkatëse integrohen në raportet vjetore të njësisë bazë. Të gjitha raportet e hartuara kombinohen në raportin përfundimtar institucional, i cili miratohet në Senat dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit. I gjithë ky proces dokumentohet në të gjitha hapat e tij, për të siguruar transparencën e nevojshme dhe një proces gjithëpërfshirës për promovimin e praktikave pozitive. <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu III, neni 28.</i> <i>Annex Nr. 3.7- Raporti Periodik i NJSBC</i> <i>Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional.</i> <i>Annex Nr. 3.8- Analiza vjetore e punës së Departamentit të Shkencave Sociale</i> <i>Annex Nr. 2.5- Rregullore e Programit: Struktura e planit mësimore dhe përmbajtja lëndore 2022.</i> <i>Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së UNIKO</i> <i>Annex Nr. 3.27- Analizë Vjetore e Punës së FSHNH</i> <i>Annex Nr. 2.17- Rregullore e Njësisë Bazë.</i> <i>Annex Nr. 2.11- Vendimi i Njësisë Bazë për emërtimin e koordinatorit të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e	Përfshirja e studentëve me sugjerimet e tyre falë anketave të përgatitura, si edhe komunikimin e vazhdueshëm të studentëve dhe pedagogëve krijon mundësinë e përfshirjes së pritshmërive në ardhmen. Fushat kryesore ku përqendrohet hartimi i RVB janë: a) ofrimi i programeve të studimit; b) organizimi, drejtimi

praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	dhe administrimi i programeve të studimit, mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat; c) burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programeve të studimit; d) studentët dhe mbështetja e tyre; e) sigurimi i cilësisë dhe programeve të studimit. Siç u theksua edhe në takimin me stafin skademik të Programit, përveç strukturave të ndryshme të IAL, kjo praktikë bashkërendohet si me vlerësimet e jashtme – falë edhe anëtarit të jashtëm të NJSBC- sic u përmend më lart, por dhe duke harmonizuar dhe shpërndarë përvojën e përparuar brenda institucionit për të stimuluar më tej arritjen e rezultateve sa më të larta. <i>Annex Nr. 3.8- Analiza vjetore e veprimtarisë së Njesisë Bazë</i> <i>Annex Nr. 1.3- Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2022-2027</i> <i>Annex Nr. 4.28- Tabela e të dhënave për kualifikimin kërkimor dhe shkencor</i> <i>Annex Nr. 2.4- Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit</i> <i>Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së UNIKO</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	IAL përdor një sërë mekanizmash për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë si p.sh. vlerësimet e studentëve, kolegëve, alumni, partnerëve të IAL, që kanë si objektiv identifikimin e aspekteve për tu përmirësuar dhe evidentimin pikave të forta për tu shpërndarë tek i gjithë stafi. Për këtë qëllim NJSBC përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që nga pyetësorët e studentëve, vlerësimi i përparimit të tyre deri tek vlerësimi/vetëvlerësimi i stafit akademik. Përparimi i studentëve bazohet në vlerësimin e tyre individual falë notës përfundimtare në çdo lëndë e cila përbehet nga: a) 30% vlerësimi i vazhdueshëm i pjesmarrjes në mësim; b) 70% nga vlerësimi përfundimtar. Kovertimi nga pika në nota kryhet sipas një skeme të caktuar. Në këtë vlerësim përfshihet edhe praktika profesionale që vlen 5ECTS dhe gjatë së cilës studenti ndiqet nga një pedagog i departamentit, i cili në përfundim të praktikës profesionale harton një raport dhe vlerëson studentin. Një tjetër mekanizëm i përdorur për rritjen e cilësisë është edhe organizimi i seminareve akademike, procesi i rishikimit të syllabuseve ku merret në konsideratë edhe mendimi i studentëve, procesi i monitorimit të programeve mësimore, etj të cilat bëhen transparente për të zbatuar një proces sa më të drejtë




	dhe gjithëpërfshirës. Integrimi i cilësisë së mësimdhënies me politikat mbështetëse për studentët krijon mundësinë e pasjes së disa strukturave në dispozicion të këtij objekti siç janë për shembull Koordinator i Programit, Zyra e Zyra e Karrierës etj. Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu III, neni 28. Annex Nr. 3.8- Raportet vjetore te NJSBC Annex Nr. 2.5- Rregullore e Programit të Studimit. Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së UNIKO
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e koMShetencave të përfuara nga ky program.	Të gjitha grupet e interesuara siç janë studentët aktualë apo ata të diplomuar, stafi akademik dhe administrativ përdorin instrumentat e lartëpërmendura për të bërë vlerësimin e performancës së programeve të studimit duke bërë të mundur edhe arritjen e dy objektivave strategjikë: a) vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së pedagogëve nëpërmjet ku përfshihen: mësimdhënia; kërkimi shkencor; shërbimi dhe administrimi; vlerësimi i mësimdhënies nga studentët; b) përfshirjen në vlerësimin e fushës së mësimdhënies përfshihen: përputhja e syllabus të lëndës me programin; metodologjia e mësimdhënies; oranzimi dhe drejtimi i mësimin; lidhja e teorisë me praktikën; përdorimi i teknologjisë në mësim; format e vlerësimit të studentit; komunikimi me studentët dhe integriteti i pedagogut. Zyra e Karrierës mban kontakte të vazhdueshme me Alumnin duke i angazhuar vazhdimisht në aktivitetet e organizuara nga universiteti dhe duke thithur mendimin e tyre dhe të insitucioneve partnere. Shumë prej tyre marrin pjesë në Panairat apo aktivitetet e tjera tematike të cilat organizohet në mënyrë periodike nga IAL. Në bazë semestrale zhvillohet edhe një rishikim i cilësisë së përmbatjes së lëndëve dhe rezultateve të provimeve përmes sistemit interaktiv të institucionit dhe nga Drejtoria e Kurrikulave e cila përgatit një raport vjetor. Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë së UNIKO
Konkluzione	<i>IAL monitoron dhe vlerëson përmes NJSBC dhe strukturave të tjera në të gjitha nivelet dhe me pjesëmarrjen e stakeholders si të brendshëm edhe të jashtëm në mënyrë periodike cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese të programit dhe</i>

	<i>kapaciteteve profesionale të studentëve për të qenë sa më të përgatitur për nevojat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Si një qendër e rëndësishme e zhvillimit të jetës shkencore dhe akademike në qytetin e Korçës, IAL siguron një përfshirje të të gjithë aktorëve të jashtëm dhe të brendshëm të sigurimit të cilësisë, falë strukturave të ngritura dhe procedurave të zbatuara në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si edhe në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në “Planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit 2022-2025”. IAL synon rritjen e cilësisë së mësimdhënies duke përthithur nevojat e tregut të punës dhe hartuar kurrikulat përkatëse për t’iu përgjigjur sa më mirë këtyre kërkesave. NJSBC si struktura përgjegjëse por edhe mekanizma të tjera që marrin pjesë në procesin e sigurimit të cilësisë mbështeten nga eksperti i jashtëm dhe nga ai ligjor për një angazhim sa më të efektshëm të burimeve njerëzore me qëllim përmbushjen e detyrave dhe bazohen në përmbushjen e procedurave të sanksionuara në Manualin e Cilësisë <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu III, neni 28.</i> <i>Annex Nr. 1.3- Planin Strategjik të Zhvillimit të UNKO 2022-2025</i> <i>Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional.</i> <i>Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët	Spektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni planifikon organizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe vlerësimit të brendshëm institucional. Ky sektor ndjek një sërë problematikash dhe detyrash siç janë: a)

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	hartimi, organizimi dhe zbatimi i programeve të reja të studimit; b) mbarëvajtja e veprimtarive kërkimore në institucion duke përfshirë edhe aplikimin, menaxhimin dhe mbarëvajtjen e projekteve kërkimore dhe botuese; c) mbarëvajtjen e procesit të dixhitalizimit të të dhënave të programeve të studimit, stafit akademik, dhe studentëve nëpërmjet sistemit elektronik. Kjo strukturë me mbështetjen e dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve analizon dhe rishikon programet e studimit, planet mësimore, si edhe kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë. Si strukturë përgjegjëse, NJSBC ka hartuar një rregullore të brendshme për organizimin dhe punën e GVB për garantimin e standarteve të cilësisë, si edhe njësimit e sigurimit të cilësisë. Kjo rregullore është hartuar duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 në nenin 103 dhe 104, në Nenin 28 të Statutit të IAL, si edhe në rregulloret për Sigurimin e Cilësisë. Kësaj rregulloreje i bashkëngjitet edhe rregullorja e kontrollit të cilësisë. Këtyre strukturave edhe procedurave i bashkëngjitet edhe plani i veprimit i hartuar nga NJSBC për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Brodi i Akreditimit për çdo program studimi, në të cilën përcaktohen detyrat për çdo strukturë të IAL. <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu III, neni 28.</i> <i>Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional.</i> <i>Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	NJSBC dhe të gjitha strukturat duke përfshirë Dekanët e Fakulteteve dhe Përgjegjësin e Departamentit janë përgjegjës për çështjet e cilësisë, nëpërmjet monitorimit - falë mekanizmave të përmendura më lart. Njësia bazë është përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e të gjithë këtyre formave të monitorimit dhe në bashkëpunim me organet përkatëse të sigurimit të cilësisë bën të mundur analizimin e të dhënave të marra – falë bashkëpunimit me zyrat administrative - dhe përgatitjen e hapave të caktuar për përmirësimin e problemeve të vërejtura dhe përgjithësimin e praktikave pozitive si përkruhet në statutin e IAL. <i>Annex Nr. 3.3- Vendimi për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të brendshëm nga Departamenti</i> <i>Annex Nr. 3.4- Lista e anëtarëve të NJSBC</i>

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Karakteristikat kryesore që karakterizojnë anëtarët e NJSBC janë: integriteti; pavarësia dhe objektiviteti; profesionalizmi; dhe aftësia për të komunikuar dhe informuar. Anëtarët e kësaj strukture zgjidhen nga Senati Akademik dhe anëtarët e tij përfaqësojnë të gjitha fakultetet dhe këshillin studentor për të mundësuar sigurimin e cilësisë në përputhje me kuadrin ligjor siç theksohet në statutin e universitetit. Për të shmangur pabarazinë ose diskriminimin ndaj personelit dhe studentëve, IAL ka hartuar Kodin e Etikës bazuar në legjislacionin përkatës si të administratës publike ashtu edhe Ministrisë së Arsimit. Anëtarët e këtyre organeve përzgjidhen nga stafi akademik me eksperiencë dhe me integritet për të shmangur çdo lloj pabarazie në trajtimin e studentëve apo pedagogëve. <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu III, neni 28.</i> <i>Annex Nr. 1.5- Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Insitucional.</i> <i>Annex Nr. 1.16- Manuali i Cilësisë</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Për të rritur më tej cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, IAL angazhon edhe partnerët strategjikë të insitucionit apo Alumni përmes zyrës së karrierës në hartimin apo rishikimin e kurrikulave sic theksohet në statut. Kjo bëhet me qëllim që të kuptohen sa më mirë nevojat e tregut të punës dhe sugjerimet e mbledhura të integrohen në kurrikulat mësimore. Bashkëpunimi me partnerët e jashtëm përfshin edhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionet homologe me qëllim përthithjen e përvojës së përparuar <i>Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu III, neni 28.</i> <i>Annex Nr. 1.3- Planin Strategjik të Zhvillimit të UNKO 2022-2025</i> <i>Annex Nr. 3.29- Tabele përmbledhëse për marrëveshjet e bashkëpunimit.</i> <i>Annex Nr. 3.6- Raport i Përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit</i>
Konkluzione	<i>IAL përdor disa mjete për monitorimin e cilësisë dhe përfshin: a) njësitë akademike nëpërmjet monitorimit periodik; b) personelin akademik; c) studentët në nëpërmjet anketave dhe mekanizmave të ankimit në proceset e kontrollit të cilësisë së programit të studimit; d) mendimet e partnerëve institucionale dhe alumni. Në rastin e evidentimit të problemeve apo praktikave pozitive krijohet</i>

	mundësia që nëpërmjet formave të njehsuara siç janë raportet apo edhe takimet tematike të informojë palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe të kërkojë përpilimin e masave nëpërmjet departamentit si edhe zbatimin e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Statutin në Rregulloren e Institucionit, në Planin Strategjik por edhe në politika specifike për përmirësimin e cilësisë. Ndërkohë që informacioni lidhur me këto akte ligjore publikohet dhe përditësohet rregullisht në faqen e internetit të institucionit. Po kështu publikohen edhe rregullorja e njësisë, KPSC, si edhe Manuali i Sigurimit të Cilësisë https://unkorce.edu.al/akreditimi/. Ky informacion i vihet në dispozicion studentëve edhe nëpërmjet informacionit të hartuar për studentët. Annex Nr. 3.7- Raportet Vjetore të NJSBC 2-15-2021 Annex Nr. 3.6- Pyetësori Studentor/Raport
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	IAL publikon si në formë të shtypur ashtu edhe elektronike në faqen e universitetit të gjitha vlerësimet e programeve të studimit për akreditimin institucional dhe vë në dispozicion të gjitha vlerësimet nga ASCAL https://unkorce.edu.al/akreditimi/. Kjo gërshetohet edhe me vlerësimet e studentëve për pedagogët, të cilat përpunohen nga NJSBC dhe vihen në dispozicion të departamentit dhe fakultetit në mënyrë elektronike, ndërsa konkluzionet dhe komentet u bëhen me dijë pedagogëve përkatës pasi ka përfunduar lënda për të ruajtur konfidencialitetin. Annex Nr. 1.1- Statuti i Universitetit të Korces, Kreu III. Annex Nr. 1.2- Rregullore e UNIKO



	Annex Nr. 2.3- Analiza vjetore e veprimtarisë së Njesisë Bazë. Annex Nr. 3.6- Pyetësi Studentor/Raport Annex Nr. 3.7- Raport Vjetor i NJSBC
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Vlerësimet e kryera dhe rezultatet përkatëse për programin pasqyrohen në Raportin Vjetor të Departamentit dhe shoqërohen me një plan veprimi. Duke u nisur nga ky plan veprimi dhe bazuar në një kalendar të brendshëm, NJSBC përgatit plan-veprimin, i cili i paraqitet dekanatit dhe miratohet nga Senati Akademik së bashku me projekt-buxhetin përkatës duke përfshirë nevojat për përmirësimet akademike dhe aktivitetet e departamentëve që synojnë rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të cilësisë akademike. Këto rekomandime parashtrohen në formën e orientimit dhe në funksion të realizimit të misionit dhe vizionit të përmbushjes së programit. Annex Nr. 3.8- Analiza vjetore e Njesisë Bazë. Annex Nr. 3.27- Analiza vjetore e punës së FSHNH Annex Nr. 2.4- Plan Strategjik i zhvillimit të programit. Annex Nr. 2.5- Rregullore e programit Annex Nr. 3.7- Raport Vjetor i NJSBC
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Harmonizimi i aktivitetit të strukturave të ndryshme të institucionit me NJSBC siguron koherencë dhe gjithëpërfshirje në drejtim të sigurimit të cilësisë falë mbledhjes së të dhënave dhe analizës së informacionit duke hartuar sugjerimet dhe përmirësimet përkatëse. Raportet vjetore të përgatitura ku përfshihen veprimtarinë që këto struktura kanë realizuar për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet e programeve mësimore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Annex Nr. 3.27- Analiza vjetore e punës së FSHNH Annex Nr. 2.4- Plan Strategjik i zhvillimit të UNIKO 2022-2027. Annex Nr. 3.7- Raport Vjetor i NJSBC
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Për të përmirësuar më tej metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies IAL zbaton aktivitete të ndryshme si për shembull bashkëbisedime periodike me studentët dhe stafin, thithjen e mendimeve nëpërmjet anketave me studentë, pedagogë, alumni, kompanitë partnere, alumni, vizitat e ekspertëve të huaj akademikë dhe jo-akademikë, organizimi i vizitave studimore dhe kërkimore në terren, si edhe trainime për të kërkuar metodologjitë për ti përmirësuar programet dhe infrastrukturën në dispozicion për të qenë sa më pranë nevojave të studentëve Annex Nr. 3.8- Analiza vjetore e Njesisë Bazë.
Konkluzione	Prioritetet e vendosura, politikat, proceset e zbatuara, kriteret e

	<i>përdorura dhe veprimtaritë e zhvilluara për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente për të bërë sa më efektive implementimin e tyre, duke synuar krijimin e një kulture institucionale për arritjen e cilësisë dhe përmirësimin e proceseve për monitorimin e saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në “Etika dhe Liderhipi”, Universiteti “Fan.S. Noli” Korçë

Pika të forta dhe afirmime:

1. Institucioni ka infrastrukturë moderne për zhvillimin e procesit mësimor.
2. Institucioni ka angazhuar në programin e studimit staf akademik me përvojë në fushat respektive dhe me karrierë të konsiderueshme akademike.
3. Institucioni ka një infrastrukturë institucionale të mirë-organizuar dhe mbështetje finaciare për mobilitetin e studentëve dhe zhvillimin akademik të pedagogëve.
4. Institucioni ka ndërtuar bashkëpunime të frytshme me institucionet publike e jopublike në vend si dhe me universitetet e huaja.
5. Organizimi i mësimit pas orës 15:00, është një praktikë pozitive për t’iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të studentëve shumica e të cilëve janë në marrëdhënie pune.
6. Pjesëmarrja e studentëve në projektet kërkimore është edhe një nga kriteret e përzgjedhjes së këtyre projekteve të financuara nga fondi i universitetit, cka nxit më tej dëshirën e pedagogëve për të angazhuar më tej studentët.
7. Pothuajse i gjithë stafi ka marrë pjesë në projektet Erasmus+ për të përmirësuar më tej kompetencat si në fushën e mësimdhënies ashtu edhe në atë kërkimore. Aktualisht institucioni ka krijuar një fond të brendshëm për të mundësuar pjesëmarrjen apo botimet e pedagogëve në revista me impakt faktor dhe ky fond arrin deri në 400 euro në vit.
8. IAL shikon me përparësi nevojën e specializimit të mëtijshëm të pedagogëve, e cila diktohet edhe nga mobiliteti në rritje i studentëve si në dalje ashtu edhe në ardhje pranë këtij universiteti.

Pika të dobta

1. Mospërputhje e fushës së programit të studimit në Shkenca Sociale (Kategoria nr.3) me njësinë kryesore, Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane (Kategorive nr. 4 dhe nr.2) sipas standardeve ndërkombëtare ISCED 2011. Bazuar në kategorizimin e ISCED, programi dhe njësia kryesore janë në nivele të ndryshme. (Standardi I, Kriteri II).



Rekomandime:

1. Referuar mospërputhjes së fushës së programit të studimit me njësinë kryesore, Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, kërkohet reflektim nga institucioni që të përmbushë si standardet ndërkombëtare ISCED, edhe legjislacionin shqiptar si VKM nr.288, date 11.05.2022 dhe VKM nr.310, date 11.05.2022. kërkohet reflektim nga institucioni. **(Standardi I, Kriteri II)**
2. GJV mendon se praktika duhet të jetë më e profilizuar për ti bërë të mundur studentëve që të specializohen në fushat përkatëse të etikës dhe lidërsip dhe jo vetëm të kryejnë praktikën në një sërë institucionesh publike me një sistem rotacioni dhe periudhë të përcaktuar në secilin prej tyre. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që praktika të jetë sa më efektive duke i drejtuar studentët drejt tregut të punës.
3. Është i nevojshëm një profilizim i mëtëjshëm i drejtimeve që i ofrohen studentit si në fushën e etikës ashtu edhe në atë të lidërsip. Në momentin aktual është me vend që të kalohet nga konceptet e teorike të lidërsip dhe ato filozofike të etikës që më tepër do të shërbenin si lëndë transversale për formimin e përgjithshëm të studentëve, në fazën e aplikimit të tyre në drejtime konkrete që kërkohen nga realiteti i zhvillimit siç janë për shembull: etika dhe inteligjenca artificiale; etika dhe bioteknologjia; etika e kërkimit shkencor; etika në fushën e shëndetësisë; lidërsip në nivelin lokal etj.
4. Në kuadër të kontrollit të cilësisë, GJV vërejti se pasi i raporti i vlerësimit shkon në dekanat, atëherë nuk ka një procedurë që kontrollon ecurinë apo zbatimin e rekomandimeve të këtyre raporteve, apo një praktikë për përkthimin e problemeve të ngritura në hapa konkretë - si për shembull trajnime, tryeza të rrumbullakëta me tematika specifike apo ndarje të eksperiencës pozitive - nga ana e dekanatit apo e njësisë bazë për përmirësimin e performancës akademike.

Conclusions of the Evaluation for the Second Cycle Master's Program in "Ethics and Leadership," "Fan S. Noli" University, Korça.

Strengths and affirmations

1. The institution has modern infrastructure for the development of the teaching process.
2. The institution has engaged academic staff with experience in their respective fields and with considerable academic careers in the study program.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



3. The institution has a well-organized institutional infrastructure and financial support for student mobility and the academic development of faculty members.
4. The institution has built fruitful collaborations with public and non-public institutions in the country as well as with foreign universities.
5. Organizing classes after 3:00 PM is a positive practice to better respond to the needs of students, the majority of whom are employed.
6. Student participation in research projects is one of the criteria for selecting these projects funded by the university's fund, which further encourages faculty members to engage students.
7. Almost all of the faculty has participated in Erasmus+ projects to further improve their competencies in both teaching and research fields. Currently, the institution has created an internal fund to support faculty participation or publications in high-impact factor journals, and this fund reaches up to 400 euros per year.
8. The institution prioritizes the need for further specialization of faculty members, which is also dictated by the increasing mobility of students, both outgoing and incoming to this university.

Weaknesses

1. **Mismatch of the field of study in Social Sciences (Category no. 3)** with the main unit, the Faculty of Natural Sciences and Humanities (Categories no. 4 and no. 2), according to the international ISCED 2011 standards. Based on the ISCED categorization, the program and the main unit are at different levels. **(Standard I, Criterion II)**

Recommendation

1. Regarding the mismatch between the program field of study and the main unit, the Faculty of Natural Sciences and Humanities, it is requested that the institution reflects in order to meet both international ISCED standards and Albanian legislation, such as Council of Ministers Decision no. 288, dated 11.05.2022, and Council of Ministers Decision no. 310, dated 11.05.2022. Reflection is required from the institution. **(Standard I, Criterion II)**



2. **The External Evaluation Group (GVJ)** believes that the professional internship should be more specialized to enable students to specialize in the relevant areas of ethics and leadership, and not only perform their internships in various public institutions with a rotation system and a set period in each one. This way, the practice can be more effective by guiding students towards the job market.
3. **Further profiling of the directions offered to students in both ethics and leadership is necessary.** Currently, it would be appropriate to move from theoretical concepts of leadership and philosophical concepts of ethics, which would serve more as transversal subjects for the general formation of students, to their application in concrete areas required by the realities of development, such as: ethics and artificial intelligence; ethics and biotechnology; ethics of scientific research; ethics in healthcare; leadership at the local level, etc.
4. **In the context of quality control, the GVJ noted that once the evaluation report reaches the dean's office,** there is no procedure in place to monitor the progress or implementation of the recommendations from these reports, nor is there a practice for translating raised issues into concrete steps – such as training, roundtable discussions on specific topics, or sharing positive experiences – by the dean's office or the basic unit for improving academic performance.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMSHETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

